

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7812 E mërkurë 6 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Sot, mbushen 100 vjet nga data 6 Smars i vitit 1919, kur oficerët Bajram Hallkocendi dhe Demo Korça, i dorëzuan në Përmet të dërguarit personal të ...
Vijon në faqen 20

Nga ILJAZ ISMAILI

Bajram Hallkocendi,
oficeri që i shkroi Uillonit



Opinion i Ditës

Ne nuk mund të lejojmë që nacionalistët të shfrytëzojnë zemërimin publik. Unë dua një projekt ambicioz që lejon njerëzit të marrin kontrollin ...
Vijon në faqen 21

Nga EMMANUEL MACRON

E dashur Europë, Brexit është një mësim për të gjithë ne



Kryemadhi: Në verë, zgjedhje të parakohshme

Opozita tri orë para parlamentit, Basha: 16 marsi, protesta vendimtare

Shashka, tymuese, digjen goma para Kuvendit. Rudina nuk dorëzon mandatin, Kiri pranë Bashës

Nga VALENTINA MADANI

Opozita protestoi dje për tri orë me radhë para parlamentit nën masa të rrepta sigurie. Qytetarët e shumtë protestuan jashtë Kuvendit, teksa në sallë bëhej betimi i katër deputetëve të LSI-së, që u ulën në karriget e lëna bosh nga opozita ...
Në faqen 2-3

EMRAT/ TOKAT E ZENA NGA "INFORMALET", KUSH PERFITON NGA FONDI I ALUIZNIT

KOMPENSIMI, 750 PRONARET QE NDAJNE 5 MILIONE USD

Familjet në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë që marrin 523 milionë lekë të reja. Pronarët e tjerë duhet të paraqesin në ATP kërkesën për kompensim



(Në foto) Zonë informale

Në faqen 7

TRAFIKU NE PORT

U arrestuan për korrupsion, gjykata liron 6 policët e arrestuar

Në faqen 9

OPERACIONI

Shkatërrohet grupi i heroinës dhe kokainës në Tiranë, arrestohen 2 veta

Në faqen 8

DEMSPERBLIMI

Të përndjekurit, 5 mijë emrat dhe dokumentet në dosjen e secilit

Në faqen 18-19

INTERVISTA

Stela Rustemaj, artistja e re që pikturon me trup: Bëhem një me veprën

Suplement

LISTA E FITUESVE



590 studentët ekselentë që do të fillojnë punë në administratë

Në faqen 12

Kryeministri flet në Kuvend dhe 'fluturon' në Itali, në emisionin e Bruno Vespës

Rama nuk tërhiqet: Fitojmë të gjitha bashkitë

Betohen 4 deputetë të rinj, kush janë të tjerët që do të marrin mandatin

Masat e forta të sigurisë kanë mundësuar mbajtjen e seancës së radhës plenare. Ndërsa jashtë ambienteve të Kuvendit protestuesit ishin mbledhur në hyrjen kryesore, policia dhe Garda e Republikës kishte boshatisur gjithë pedonalen "Murat Toptani" për të kri-



juar një korridor hyrës për deputetët dhe anëtarët e qeverisë. Pikërisht nëpërmjet këtij korridori u fut edhe kreu i qeverisë, Edi Rama, i cili ndryshe nga herët e shkuara mori pjesë në seancë për të përcjellë disa mesazhe për opozitën ...
Në faqen 4-5

PROTESTA OPOZITA

Kreu i PD i numëron Ramës tik-takun e ikjes: 16 marsi, protesta vendimtare

Valentina Madani

Opozitës do t'i duhet edhe një tjetër protestë për të rrëzuar Edi Ramën nga pushteti. Nën thirrjet "Rama ik!" djegie gomash apo shpërthim shashkash kryetari i PD-së, Lulzim Basha, ftoi shqiptarët nga mbarë vendi që t'i bashkohen protestës kombëtare para Kryeministrit më 16 mars. Basha akuzoi kryeministrin Rama se ka shkelur dinjitetin e shqiptarëve dhe se do të shkojë në burg. Basha deklaroi se vetëm zgjedhjet e lira dhe të ndershme do të hapin rrugën e vendit drejt anëtarësimit në BE. Basha tha se më 16 mars, populli do të marrë në dorë fatet e tij. Z.Basha tekta i cilësoi deputetët e rinj si tradhtarë u kërkoi protestuesve që të nisen drejt KQZ-së, me qëllim që të gjithë kandidatët e tjerë të listës vijuese të dëgjin mandatet e tyre. I ndjekur nga protestuesit në mbyllje të protestës së djeshme nga selia e Partisë Demokratike, z.Basha u bëri thirrje qytetarëve që të bashkohen në protestën vendimtare. "Dua t'u bëj një thirrje të gjithë qytetarëve në një tjetër akt vendimtar të hapjes së portave të zgjedhjeve të parakohshme, pa Edi Ramën, në një javë tjetër që do të na bashkojë më shumë në 16 mars, në protestën vendimtare për ta përcjellë kufomën politike, për të shpëtuar të ardhmen tonë, madje edhe për të çliruar Partinë Socialiste", u shpreh z.Basha. Kreu i opozitës duke folur për simpatizantët e tij nga selia blu deklaroi se 16 marsi do të jetë dita kur opozita do të organizojë protestën më të madhe dhe do t'i japë fund parlamentit të kimit. "Populli i bashkuar ka përfunduar etapën e fundit të asgjesimit të Asamblesë së Kimit dhe nxjerrjen e kësaj asambleje lakuriq para botës si kazani i plehrave, horrave, hajdutëve dhe kriminelëve. Ka meritën e ndezjes së shpresës dhe besimit të çdo shqiptari për të nesërmen që po vjen. Sot e kemi çuar njëherë e mirë në shtëpi parlamentin e kimit, parlamentin ilegjitim dhe kemi hapur përfundimisht shërgun e vetëm për më të cilës do të kalojë e ardhmja e çdo shqiptari. Zgjidhja e vetme politike është largimi një orë e më parë i kryezullunqarit Edi Rama. Dua t'u bëj një thirrje të gjithë qytetarëve shqiptarë të marrin pjesë në një tjetër akt vendimtar të hapjes së portave të shpresës, hapjes së portave të Europës, të zgjedhjeve të parakohshme të lira dhe të ndershme pa Edi Ramën, horrat dhe kriminelët e tij. Me një akt tjetër të madh që do të na bashkojë trefish

Skenari, Basha-shqiptarëve: Mos kini frikë, gati për uraganin popullor

"Rama në burg, deputetët e rinj si tradhtarë"



Kreu i PD-së, Lulzim Basha dje në protestë

VANGJEL DULE

"Aristoteli në shekullin e katërt para Krishtit dallonte 6 sisteme politike, 3 pozitive dhe 3 negative. Ndër to, më të keq konsideronte tiraninë. Tirania është ai lloj sistemi në të cilin pushtetin e merr një individ, tirani, përmes dhunës ose mashtrimit dhe e ushtron atë me kriter interesin vetjak dhe me sjellje despotike ndaj komunitetit. Dallon kush ndonjë ngjashmëri me situatën e sotme në Tiranë"?!

THIRRJA

"Mos kini frikë, asgjë nuk do ta ndalë popullin nga vullneti për të marrë në dorë fatin e tij, ajo që po vjen është liria, sovraniteti, fundi i arrogancës, hajdutërisë, kimit të qeverisë, ajo që po ndërtojmë bashkë është Shqipëria e shqiptarëve me dinjitet, mirëqenien dhe mundësi sot e sa të jetë jeta. Bëhuni gati për uraganin e pamposhtur popullor, që do të pastrojë horizontin dhe do tua kthejë vendin shqiptarëve të vërtetë", tha z.Basha.

"As plumbat nuk i ndalin protestuesit"

Kryemadhi: Vera do të na gjejë me zgjedhje të reja parlamentare

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, pas mbledhjes së djeshme të opozitës së bashkuar deklaroi se me qeverinë nuk ka më dialog, por vetëm zgjedhje të parakohshme. Kryemadhi njoftoi se PS-ja në rrethe ka nisur fushatën dhe ka hapur zyrat elektorale për zgjedhjet parlamentare dhe jo ato lokale. "Sot qeveria është kthyer në një institucion që bën qoka në funksion të grupeve të caktuara të interesit. Nuk ka më dialog, por zgjedhje të reja. Vetë socialistët, edhe pse bëjnë



si të fortë, po përgatiten për zgjedhje të parakohshme, vera do të fillojë me zgjedhje parlamentare dhe jo lokale. Në Fier e në disa qytete të tjera ata kanë hapur zyrat elektorale dhe po fillojnë fushatën", tha Kryemadhi. Më

më shumë se me 16 shkurt, me 16 mars në protestën vendimtare për ta përcjellë kufomën politike të sektit kriminal të rilindjes, për të çliruar Shqipërinë, të ardhmen tonë, për të çliruar zgjedhjet, eko-

nominë, madje për të çliruar dhe vetë PS", u shpreh z.Basha. Kreu i PD-së siguroi shqiptarët se në betejën për rikthimin e lirisë do të jenë të fituar. "Mos kini frikë, asgjë nuk do të ndalë popullin nga

herët gjatë protestës, ajo deklaroi: "Mos kujtoni se njerëzit frikësohen me gaz lotsjellës, as plumbat nuk kanë për t'i ndaluar qytetarët. Ashtu siç nuk i ndaluan në '90, në '97, ashtu nuk kanë për t'i ndaluar dhe tani në 2019. E drejta është me ne, e drejta është me qytetarët, me të rinjtë dhe të rejtat që duan të ndërtojnë të ardhmen e tyre në Shqipëri". Sipas saj, Edi Rama ka dështuar me gjithë qeverisjen e tij. Kryemadhi u shpreh e bindur se më përpara do të zhvillohen zgjedhjet parlamentare se ato lokale.

vullneti për të marrë në dorë fatet e tij. Ajo që po vjen është liria juaj, sovraniteti juaj, fundi i arrogancës dhe krimi. Ajo që po ndërtojmë është Shqipëria e shqiptarëve. Kur më errësira e kimit, per-

SHKURTE

Rudina nuk dorëzoi mandatin,


Kiri Hajdari përkrah Bashës: Rama ik!

Rudina Hajdari ka refuzuar lënien e mandatit të deputetit, duke thyer kështu vendimin politik të Partisë Demokratike, por kjo nuk e pengoi të vllanë Kiri Hajdari për t'u bashkuar protestës së opozitës. Ai u pa në mesin e protestuesve përkrah kryedemokratit Lulzim Basha teksa iu drejtua edhe protestuesve me një fjalim të shkurtër. Ai qëndroi gjatë gjithë kohës pranë foltorës së improvizuar në protestën para Kuvendit, në krah të kreut të PD-së, Lulzim Basha dhe ish-kryeministrit Sali Berisha. Ai mori fjalën dhe u ngjiti në podium, duke thënë se "amaneti i Azem Hajdarit do shkojë deri në fund". "Unë jam djali i Azem Hajdarit. Amaneti i Azem Hajdarit qëndron tek ju dhe të gjithë demokratët. Liri Demokrat! Rama ik, Rama ik!", - tha ai. Pavarësisht se motra e tij, Rudina Hajdari refuzoi të dorëzonte mandatin e deputetes, ndryshe nga vendimi i marrë nga grupi parlamentar i partisë që përfaqëson, vëllai i saj ka zgjedhur të protestojë edhe dje për largimin e Ramës.

Tabaku, Ramës: PD do të vendosë taksat më të ulëta në rajon

Jorida Tabaku, ish-deputetja e PD, iu kundërpërgjigj kryeministrit Edi Rama në lidhje me deklaratën e bërë prej këtij të fundit në Kuvend ku theksoi se demokratët do të rrisin taksat. Në një postim në "Facebook", Tabaku shprehet PD ka programin më të mirë ekonomik me taksat më të ulëta në rajon dhe se do të heqë çdo barrierë që bizneset të punojnë të qetë. Tabaku e cilësoi deklaratën e Ramës si një gënjeshtëri dhe theksoi se ai duhet të largohet nga qeveria. "Rama tha se bizneset që protestojnë s'e dinë se PD do t'i rrisë taksat! Gënjeshtëri! PD ka programin më të mirë ekonomik me taksat më të ulëta në rajon. Sot bizneset e vogla protestojnë se janë futur në skemën e TVSH-së, se paguajnë 50% të të ardhurave taksa, se qeveria po u merr frymën, se taksidarët i rrinë të dera, se shteti i konsideron si armiq! PD do të ulë taksën e BV në 0,5% të xhiros, do të heqë çdo barrierë e do të ofrojë mundësinë që të punojnë të qetë! Biznesi është punëdhënësi më i madh dhe biznesi i lirë dhe i ndershëm të të ketë mundësi të lulëzojë! Prandaj sot bizneset protestojnë, Rama ik", tha zj.Tabaku.

versiteti i hajdutërisë nuk do të vendosë për ju dhe fëmijët tuaj. Ora e Shqipërisë europiane po troket, ora e largimit të Edi Ramës po troket mbrapsht: tik-tak, tik-tak! Gati për uraganin e pamposht-



Protesta e djeshme e opozitës

tur popullor më 16 mars". Për Bashën, Edi Rama dhe regjimi i tij ka marrë fund. Ndaj sipas tij, çdo tentativë nga ana e kryeministrit për të zgjatur agoniën e tij do t'i shtojë faturën para popullit.




104 kandidatë refuzojnë mandatin e deputetit, negociatat e Bashës me policinë

"Rama ik!", opozita 3 orë protestë para Kuvendit

Protestuesit hedhin shashka, tymuese dhe djegin goma

Valentina Madani

Opozita protestoi dje për tri orë me radhë para parlamentit nën masa të rrepta sigurie. Qytetarët e shumëj protestuan jashtë Kuvendit, teksa në sallë bëhej betimi i katër deputetëve të LSI-së, që u ulën në karriget e lëna bosh nga opozita pas djegies së mandateve. Protesta edhe dje nisi në të njëjtën orë me nisjen e seancës plenare, në orën 10:00. Lulzim Basha dhe Sali Berisha lanë selinë e PD-së dhe iu drejtuan qindra protestuesve para Kuvendit. Rrugës iu bashkua edhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi. Deputetët në parlament filluan të hyjnë në Kuvend që në orën 9 të mëngjesit për të shmangur incidentet me protestuesit. Opozita u bëri ftesë edhe studentëve që t'i bashkohen protestës, ashtu siç bëhë edhe banorët e "Astirit". Nuk pati akte dhune dhe as përdorim gazi nga Garda. Policisë iu desh vetëm një moment të ndërhyjë me ujë, kur protestuesit tentuan të rrezojnë derën që lidh Kuvendin me ish-selinë e PD-së.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha dhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi dje duke iu drejtuar KQZ-së

TENSIONIMI

Mbërritja e opozitarëve në hyrje të godinës së KQZ-së u shoqërua me tensione, për shkak të kordonit të policisë, për të cilin z.Basha deklaroi se po tentohen provokime. Më pas Basha, Kryemadhi dhe kreu i PR-së, Mediu hynë në ambientet e brendshme të KQZ-së.



Kandidatët e opozitës që refuzuan mandatin: Nuk bashkohemi me deputetët e blerë

Jo vetëm deputetët që lanë mandatin, por edhe ata që refuzuan ta marrin sipas listës shumëmerore, deklaruan dje në protestë se nuk ka kthim prapa deri në rrezimin e qeverisë. Teksa në parlament po zhvillohej seanca plenare, opozita e bashkuar është mbledhur në protestë. Ish-deputetë dhe përfaqësues të opozitës kanë mbajtur fjalime në protestën përpara Kuvendit. Pjesë e personave të cilët folën ishin Gerti Bogdani, Erisa Xhixho etj. Kandidati i PD-së tha se ky Kuvend është Kuvendi i votave të vjedhura dhe jo i shqiptarëve dhe për këtë arsye ka refuzuar mandatin e deputetit. Edhe Erisa Xhixho tha se nuk e pranoi mandatin e deputetes pas dorëheqjes së opozitës. Ajo tha se votat u blenë nga qeveria. Mirela Tabaku theksoi se Shqipëria renditet e para për nga vdekshmëria foshnjore, largimin e mjekëve, e fundit ndaj kujdesit shëndetësor. "Unë nuk mund të jem kurrë pjesë e këtij parlamenti. Rama ik!" Bernadeta Syku nga Shkodra nuk pranoi të marrë mandatin e deputetes. Në protestë ajo theksoi se si familje e persekutuar nga regjimi komunist, kërkon një parlament të pastër nga krimi. "Një porosi për z.Lleshaj. Burrat malësorë nuk e kanë pasur zakon me u shërby horrave të komunizmit. Asnjë hap pas. E duam Shqipërinë si gjithë Europa". Matilda Qurku nga qarku i Sarandës refuzoi kategorikisht të bëhet pjesë e një parlamenti të kriminalizuar. "Ai mandat nuk më përfaqëson as mua, as qytetarët e jugut". Martin Biba, kandidat i listës së PD-së për qarkun e Lezhës nuk pranoi thirrjen e KQZ për marrjen e mandatit. "Ky është mandat i turpit, të cilën e pranuan disa të tjerë. Ky përbindësh nuk bëri asgjë për sportin dhe aviacionin. Aviacionin e ktheu në fushë droge".

NDËRHYRJA

1800 efektive të policisë ishin në funksion të mbarëvajtjes së protestës jashtë ambienteve të Kuvendit, ku njëra nga hyrjet e godinës, ajo e pedonale ishte bllokuar për kalimtarët. Të vetmit që mund të kalonin ishin deputetët dhe anëtarët e qeverisë, të cilët mbërritën në seancë rreth orës 09:30 minuta. Kryeministri Rama dhe kryetari i parlamentit, Ruçi shoqëroheshin nga forcat RENEA dhe punonjësit e Gardës. Lideri i opozitës, Lulzim Basha, përpara protestuesve e quajti karantinën të krimit parlamentin, duke mos kursyer akuzat për tradhti edhe ndaj katër deputetëve të rinj të opozitës, që u betuan në parlament. Kryeministri Rama në parlament e cilësoi protestën e opozitës jashtë parlamentit reagim të pallatit të politikës, por Lulzim Basha në krah të protestuesve tha se largimi i tij drejt Italisë ka një tjetër qëllim, të negociojë për azilin politik.

NEGOCIATAT

Pasi e akuzoi kryeministrin Rama se ka vendosur një regjim ushtarak, Lulzim Basha i ftoi protestuesit ta ndiqnin në KQZ, ku një pjesë e kandidatëve të listës shumëmerore të opozitës dorëzuan kërkesën ku refu-

MONITORIMI
Të pajisur me maska antigaz, protestuesit e opozitës janë kujdesur të mos harrojnë as parullat anti-Rama, arsyetja kryesore e kësaj proteste dhe të tjerave para saj. Ndërkohë, nga tarraca e Kuvendit, Garda zuri pozicionet duke monitoruar situatën nga lartë ndërkohë që zhvillohej seanca plenare.

KUNDRAGAZI
Jo vetëm policia, por edhe protestuesit duket se kanë zënë mend nga protestat e kaluara dhe në shesh disa u panë me maska kundragazit. Një prej tyre tha se është pajisur me maskë kundragaz, sepse tri herë është helmuar. Në protestë u panë edhe kova të futura njëra mbi tjetrën, brenda të cilave ishin futur tymuese.

Berisha: Edi Rama i ka ditët e numëruara

Ish-kryeministri Sali Berisha, i pranishëm në protestën e opozitës së bashkuar, tha dje se kreu i qeverisë, Edi Rama, i ka ditët e numëruara dhe i këshilloi atij që të largohet ditën, pasi natën është e rrezikshme. "Një protestë jashtëzakonshme. Edi Rama shkoi, por italianët nuk i mashtron dot. Ne po tentojmë t'u kthejmë lirinë shqiptarëve. Revolta ka pushtuar zemrat e mbarë shqiptarëve. Edi Rama i ka ditët e numëruara dhe bën mirë të ikë ditën, se natën ikja është e tmerrshme", deklaroi z.Berisha.



zajnë marrjen e mandatit të deputetit. Kreu demokrat, Lulzim Basha, së bashku me protestuesit marshuan në drejtim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku kandidatët e listave zgjedhore të opozitës do të depozitonin tërheqjen nga mandati i deputetit. Edhe në KQZ policia kishte marrë masa, duke vendosur një kordon policësh në hyrje të institucionit. Bashës iu desh të negocionte me efektive të më pas dorëzoi listën e kandidatëve të opozitës. 103 kandidatët nga lista e Partisë Demokratike refuzuan marrjen e mandatit të deputetit. (Paditen e

djeshme edhe Erion Piciri, kandidat i listës së PD në Tiranë, dorëzoi mandatin e deputetit). Gjatë marshimit drejt KQZ-së, Basha shoqërohej nga drejtuesja e LSI, Monika Kryemadhi; sekretari i përgjithshëm i PD, Gazment Bardhi si dhe deputetët e opozitës apo dhe aleatët e tij. Në hyrje të KQZ-së protestuesit u ndalën nga policia, ndërsa përfaqësuesit ligjorë të opozitës së bashku me liderët u ngjiten drejt zyrave të KQZ-së, ku depozituan refuzimin e mandatit nga kandidatët pasues të listave të opozitës. Mbërritja e opozitës dhe protestuesve u shoqërua

me përplasje mes këtyre të fundit me policinë, por pa incidente serioze. Teksa marshonte drejt PD-së, ndjekur nga mijëra protestues, lideri i opozitës, Lulzim Basha, deklaroi për median se, "Rama e ka frikë popullin dhe ka të drejtë që e ka frikë. Ai duhet t'i japë zgjidhje krizës, duke u larguar, pasi asnjë ditë nuk e mban dot peng popullin".

FTESA

Mbyllja e protestës u bë para selisë së PD-së, ku z.Basha ftoi qytetarët për protestë mbarëkombëtare më 16 mars, për t'i dhënë siç tha ai, dorën e fundit largimit të Ramës. Ndryshe nga protesta e kaluara, këtë radhë kishite menduar që himnin të mos e këndonte vetë. Mësohet se para dhe gjatë protestës, policia ka ndaluar një furgon ku ndodheshin shashka dhe shkopinj, tek Gjykata e Tiranës dhe një person tjetër me biçikletë po ashtu me shashka dhe shkopinj. Nuk konfirmohet nëse do i përdornin për protestë apo jo. Përveç tymueseve, shashkave dhe djegies së gomave nga protestuesit, nuk pati tensione apo incidente serioze, që të mund të detyronin Gardën për përdorimin e gazit lotsjellës. Ndërkohë rreth orës 12:31, disa protestues shtynë dhe tentuan të rrezojnë portën që lidh Kuvendin me ish-selinë e PD-së. Në këto kushte, policia për t'i sprapsur zgjidhje të përdorë autobuset, duke i lagur.

KRIZA MAZHORANCA

Kryetarja e Delegacionit të Parlamentit Europian për Stabilizim-Asociimin BE-Shqipëri, Monica Macovei, ka reaguar pas zhvillimeve më të fundit politike në Shqipëri. Nëpërmjet një deklarate për mediat ajo shprehet se Shqipëria po përparon me hapa të shpejtë drejt Bashkimit Evropian, ndërsa shton faktin se qeveria është në rrugën e duhur duke transformuar sistemin e drejtësisë. "Unë besoj se qeveria e tanishme është në rrugën e duhur në transformimin e sistemit të drejtësisë në vend. Reforma e drejtësisë ka prodhuar rezultate të prekshme në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar", - shprehet Macovei. Ajo nga ana tjetër ka kundërshtuar qëndrimin që po mban opozita, e cila theksoi se

Macovei: Qeveria e parlamenti legjitim, gjuha e dhunës e papranueshme



Parlamenti duhet të jetë platforma e vetme për diskutimin politik. "Parlamenti shqiptar duhet të jetë platforma e vetme për diskutim politik. Deputetët e opozitës kanë tradhtuar votuesit e tyre duke hequr dorë nga mandatet e tyre dhe kanë provuar se opozita nuk po punon drejt afrimit të Sh-

qipërisë me BE", - thuhet mes tjerash në reagimin e Macovei. Sipas Macovei, veprimet e dhunshme ndaj institucioneve dhe deklaratat e politikaneve që nxisin dhunë, janë të papranueshme për demokracinë dhe vlerat evropiane. "Për fat të keq, veprimet më të fundit të opozitës rrezikojnë të rrënojnë ritmin

e reformave të tilla dhe po dërgojnë mesazhin e gabuar të partnerët evropianë. Episodet e dhunshme në të cilat opozita ka sulmuar institucionet publike, si dhe gjuha që nxit dhunën e përdorur nga udhëheqësit e opozitës janë të papranueshme për çdo demokraci evropiane", - shtoi ajo. Në fund të reagimit të saj ajo thekson se qeveria është plotësisht legjitime. "Pas zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2017 dhe raporteve të OSBE/ODHIR, si dhe vëzhguesve të tjerë nga vendet anëtare të BE-së, ne konsiderojmë që parlamenti dhe qeveria shqiptare të jenë plotësisht legjitime", - theksoi Macovei.



Seanca e djeshme parlamentare

Kryeministri akuzoi opozitën se kërkon pushtetin në tavolinë, pasi s'fiton dot zgjedhjet

Rama: S'ka zgjedhje të parakohshme, nuk negociojmë mandatin e qeverisë

"Do të gjejmë rrugën të dialogojmë me opozitën e re"

Masat e forta të sigurisë kanë mundësi të suar mbajtjen e seancës së radhës plenare. Ndërsa jashtë ambienteve të Kuvendit protestuesit ishin mbledhur në hyrjen kryesore, policia dhe garda e Republikës kishte boshatisur gjithë pëdonalen "Murat Toptani" për të krijuar një korridor hyrës për deputetët dhe anëtarët e qeverisë. Pikërisht nëpërmjet këtij korridori u fut edhe kreu i qeverisë, Edi Rama, i cili ndryshe nga herët e shkuara mori pjesë në seancë për të përcjellë disa mesazhe për opozitën dhe protestuesit, para se të nisej për në Itali ku do të merrte në një emision televiziv. Fjalën e tij kryeministri ia kushtoi plotësisht opozitës dhe situatës politike të krijuar pas dorëzimit të mandateve, teksa edhe një herë shprehu gatishmërinë për të dialoguar me të, por duke përjashtuar në mënyrë kategorike negociatat për mandatin e qeverisë dhe zgjedhjet e parakohshme. "Ne jemi gjithmonë të gatshëm të flasim në çdo moment. Dora jonë është e shtirë, gatishmëria jonë për të folur është gjithmonë. Ne jemi gati të dialogojmë për gjithçka, por ne nuk jemi gati dhe s'do jemi asnjëherë gati të negociojmë rregullat themelore që bëjnë ndryshimin mes këtij sistemi, ku njerëzit zgjedhin dhe të zgjedhurit respektojnë mandatet që u japin njerëzit dhe çdo sistemi tjetër. Këtë ne nuk jemi gati ta bëjmë. Demokracinë, parlamentarizmin dhe mbi të gjitha, mandatin e marrë nga shumica dërrmuese e qytetarëve, ne nuk e negociojmë me askënd", - tha Rama. Ai akuzoi opozitën se në pamundësi për të fituar me votë po



Kryeministri Edi Rama, gjatë seancës së djeshme parlamentare

kërkon pushtetin në tavolinë. "Këta kërkojnë atë që ne nuk mund t'ua japim dot, përmbyshjen e rregullave të lojës dhe transformimin e procesit në një proces absurd, duke krijuar dhe një precedent të papranueshëm, jo për ne, por për asnjë vend, për asnjë partner ndërkombëtar të Shqipërisë, që një opozitë, kur e sheh që nuk fiton dot zgjedhjet, ikën, djeg mandatet dhe thotë anulim loje, loja fillon nga e para", - shtoi ai. Më tej ai kërkoi të qetësoi edhe socialistët se PS

është e vendosur për të vijuar punën dhe për të kryer detyrën e qeverisjes së vendit. "Ky parlament është vendi ku na ka sjellë shumica e shqiptarëve dhe që na kanë dhënë detyrën të qeverisim deri në vitin 2021. Mandati ynë nuk është një letër bixhozi", - deklaroi Rama. Në këtë kuadër ai garantoi deputetët e vet dhe socialistët se nuk do të ketë asnjë shtyrje as të zgjedhjeve parlamentare. "Dua ta nënvizoj me shumë forcë dhe me shumë qartësi, në qershor, Shqipëria ka

zgjedhje vendore. Ata e dinë se s'kanë asnjë shans. E dini ju se në kafenenë e parlamentit jua kanë thënë vazhdimisht, e dinë të gjithë ata që i dëgjojnë bisedat e tyre, e di unë se e kam dëgjuar edhe unë nga partia e tretë e opozitës, që s'kanë asnjë shans të marrin një bashki të vetme".

zgjedhje vendore. Ata e dinë se s'kanë asnjë shans. E dini ju se në kafenenë e parlamentit jua kanë thënë vazhdimisht, e dinë të gjithë ata që i dëgjojnë bisedat e tyre, e di unë se e kam dëgjuar edhe unë nga partia e tretë e opozitës, që s'kanë asnjë shans të marrin një bashki të vetme nga ato që kemi dhe kanë shumë pak shanse të ruajnë gjysmën e bashkive që kanë. Ata e dinë shumë mirë. Për të mos thënë zero shans", - tha kryeministri. Sa i përket veprimet të opozitës për të dje-

gur mandatet, Rama u shpreh se ajo zgjodhi të vetëvritet, ndërsa theksoi se zhvillimet janë të ngjashme me ato të para dy viteve më parë, në prag të zgjedhjeve parlamentare. "Ajo që ndodh sot është vijimi i një rrugë pa krye, ku e vetmja gjë e re është një vendim politikisht vetëvrasës i udhëheqjes politike të opozitës, si rezultat i humbjes së plotë të shikimit mbi vetveten dhe mbi Shqipërinë. Faktikisht jemi në kushtet e një sezoni të ri të një seriali të njohur", u shpreh Rama. Pavarësisht kësaj ai theksoi se mazhoranca është e vendosur për të bashkëpunuar me opozitën e re që po krijohet në Kuvend për të miratuar së pari reformën zgjedhore. "Ne do të gjejmë rrugën të dialogojmë me opozitën që do të zërrë vendet këtu në sallë dhe bazuar fiksis mbi rekomandimet e ODHIR-it, bazuar mbi dakordësinë me të gjithë ekspertët dhe me të gjithë ata që janë specialistë të zgjedhjeve ndërkombëtare, ne do të shtojmë përpara. Ashtu sikundër ne do të shkojmë përpara edhe me votën e emigrantëve dhe pastaj do të shohim kush është shumicë në popullin shqiptar", - deklaroi Rama.



Protesta, mazhoranca siguroi vetëm 73 vota për të miratuar ligjet

Seanca plenare, në drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, miratoi dje katër projektligje, një projektvendim dhe një projektrezolutë. Seanca miratoi një shtesë në ligjin "Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë", disa ndryshime dhe shtesa në ligjin "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", rati-fikoi dy marrëveshje ndërkombëtare. Në emër të grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Sadi Vorpsi, u shpreh se miratimi i ndryshimeve në ligjin për letërnjoftimin është me rëndësi edhe për zgjedhjet e ardhshme lokale. Për deputetin e Partisë Socialiste ky ndryshim bëhet për t'u krijuar mundësinë e votimit, marrjen e shërbimeve publike dhe të përdorimit si dokumente udhëtimi të letërnjoftimeve aktuale përmes një shtyrjeje të afatit të rinovimit deri më 31 dhjetor 2019. Nevoja për këtë ndryshim afati vjen si pasojë e fluksit të lartë të qytetarëve aplikues.



U betuan dje 4 deputetët e rinj të ardhur nga listat e LSI, krijohet "opozita e re"

Kuvendi me 86 deputetë, 6 kandidatë të tjerë gati të marrin mandatin

Shehu: Nuk tradhtoj qytetarët që më votuan

Ka shkuar në 86 numri i deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë. Pas Lefter Kokës, Myslim Murizit dhe Rudina Hajdarit që nuk pranuan ta dorëzojnë mandatin, "opozitës" i janë shtuar edhe 4 deputetë të rinj, që dje bënë betimin si përfaqësues të popullit në Kuvend. Ata janë Ylli Shehu, Aurora Mara, Enver Roshi dhe Edmond Rrushi. Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruci, lexoi tekstin e betimit, ndërsa deputetët e rinj deklaruan vetëm "betohe". Por, para se të bënin betimin, mazhoranca mbloidi në mënyrë formale Këshillin për Rregulloren dhe Mandatet, ku dhe shqyrtoi vlefshmërinë e mandateve të marra nga 4 deputetët e rinj që vijnë nga listat shumëerore të Lëvizjes Socialiste për Integrim në Tiranë, Dibër dhe Elbasan. I akuzuar si një nga tradhtarët nga partia që e propozoi, por edhe nga e gjithë opozita, deputeti më i ri i Kuvendit, Ylli Shehu theksoi se ai nuk ishte pjesë e strukturave të LSI dhe se mandati që ai po merrte ishte detyrim moral ndaj votuesve të Kamzës dhe Paskuqanit, ku edhe ai bëri fushatë në 2017-ën. "Unë nuk jam pjesë e strukturave të LSI-së. Nëse më përjashtojnë, është e drejta e tyre, mandati është i imi. Po të ndihesha tradhtar, nuk do të isha këtu. Nuk mund të tradhtoj mijëra qytetarë që më kanë votuar", - tha Shehu. Ndërkohë që pyetjes së gazetareve nëse do të ishte një mbështetës i mazhorancës apo opozitar, Shehu që rikthehet në Kuvend, deklaroi se do të ishte përballë qeverisë në opozitë. Pavarësisht kësaj, gjatë votimit të ligjeve dhe vendimeve të tjera, dje të seancës deputetët e rinj treguan se vota e tyre do jetë e lëkundur dhe jo gjithmonë kundër qeverisë. Kjo, pasi ata votuan pro disa nga nismat që ishin në rend të ditës. Me marrjen e mandatit të deputetit, Kuvendi ka tashmë 86 anëtarë, një numër i nevojshëm ky për të votuar edhe ligje që kërkojnë një shumicë të cilësuar prej 84 votash, siç mund të jenë edhe kodet. Por ky numër pritet



Deputeti i ri, Ylli Shehu

DEPUTETËT E RINJ

- Ylli Shehu
- Aurora Mara
- Enver Roshi
- Edmond Rrushi

KANDIDATËT QË MARRIN MANDATIN

- Ediola Braha
- Elda Hoti
- Edlira Hyseni
- Ligorag Karamelo
- Majlinda Halilaj
- Lefter Maliqi

KANDIDATËT

Mandatin e deputetit pritet ta marrë Ediola Braha, që vjen nga qarku i Gjirokastrës; Elda Hoti, nga lista e Lezhës dhe Edlira Hyseni nga lista e Durrësit, të tria nga radhët e LSI-së. Ndërkohë që krahas tyre pritet të marrin mandatin edhe 3 kandidatët e PD-së, Lefter Maliqi që vjen nga lista e Beratit, Ligorag Karamelo nga lista e Korçës dhe Majlinda Halilaj nga lista e Tiranës.



Kandidatja e LSI: Ja pse do e pranoj mandatin e deputetit

Edlira Hyseni është një nga kandidatet e radhës nga listat e Lëvizjes Socialiste për Integrim që pret të marrë mandatin e deputetit për qarkun e Durrësit. Në një postim në "Facebook", ajo ka shpjeguar arsyet se pse e pranon mandatin e deputetit në Kuvend, duke kundërshtuar thirrjet e partisë së saj për të refuzuar praninë në sallën e legjislativ-it. Përveç arsyes se këtë gjë ia ka sugjeruar djali i saj, Hyseni rendit edhe faktet e tjera që e detyruan të refuzojë urdhrin e partisë që e ka propozuar në listën shumëerore të deputetëve. "Ti mam, duhet ta pranosh atë mandat, sepse partitë i bëjnë njerëzit e kush të njeh, e di se ti zgjedh me zemër, se ti ke ngritur një jetë mbi punën", - më tha Kevin, im bir, vetëm 19 vjeç. Po, unë do ta pranoj mandatin për deputetë e qarkut Durrës në Kuvendin e Shqipërisë, që mbase rastësia a mbase diçka më shumë e solli si mundësi reale në udhën time. Do ta pranoj, sepse besoj që ndryshimet vijnë me njerëzit dhe nëse nuk nisim të gjithë nga pak të bëjmë ndryshimin që presim, nuk mund të ankohejmë për askënd tjetër! Do ta pranoj, sepse u kam kërkuar mbështetje dhe votë çdo bashkëqytetarit tim që kam njohur e takuar, duke u premtuar të isha një prej tyre", - shkruan Hyseni.

Pranoi mandatin, Karamelo: E bëj për qytetarët, Kuvendi s'duhet braktisur

Ish-deputeti i Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Ligorag Karamelo do rikthehet në Kuvend. Kësaj here nga listat e partisë Demokratike për Qarkun Korçë, duke u bërë kështu pjesë e asaj që nga kryeministri Edi Rama është cilësuar si "opozita e re" në parlament. Ai nuk iu bashkua vendimit të partive opozitare për të mos e pranuar mandatin e deputetit dhe së fundi dorëzoi në KQZ edhe formuluarin e vetëdeklarimit të dekriminalizimit. Pak pasi dorëzoi formuluarin e dekriminalizimit, kreu i OMONIA-s në Korçë ka folur edhe për mediat duke theksuar se man-



Ligorag Karamelo

dati u takon atyre që kanë dhënë kontribut. Nga Korça, Karamelo dhe edhe një mesazh për kreu e PBDNJ, Vangjel Dule. "Mandati u takon atyre që kanë dhënë kontribut. Jam i detyruar të pranoj mandatin për qyteta-

rët. Me Dulen nuk jam dakord për dorëzimin e mandatit. Nuk duhet të braktiset parlamenti. Nga pozicioni që ka Dule, e justifikoj veprimin e tij. Në kushte të tjera Dule do të vepronte si unë", - tha ai.

të rritet edhe më tej, pasi në listën e prites për t'u bërë deputetë në KQZ janë edhe 6 emra të tjerë që kanë pranuar ta marrin mandatin. Bëhet fjalë për 3 emra të tjerë që vijnë nga radhët e LSI-së dhe 3 emra që vijnë nga listat e PD-së. Më konkretisht, mandatin e deputetit pritet ta marrë Ediola Braha, që vjen nga Gjirokastra, Elda Hoti, nga lista e Lezhës dhe Edlira Hyseni nga lista e Durrësit, të tria nga radhët

e LSI-së. Ndërkohë që krahas tyre pritet të marrin mandatin edhe 3 kandidatët e PD-së. Lefter Maliqi që vjen nga lista e Beratit, Ligorag Karamelo nga lista e Korçës dhe Majlinda Halilaj nga lista e Tiranës. Të 6 këta kandidatë kanë dorëzuar formuluarin e vetëdeklarimit në KQZ dhe pritet që t'i jepet mandati në një nga ditët në vijim. Pra, bashkë me këta 6 anëtarë, Kuvendi pritet të shkojë në 92 anëtarë, vetëm

1 më pak sesa është numri për të votuar nismat që kërkojnë shumicë të përforcuar votash, siç mund të jenë dhe ndryshimet kushtetuese. Por pavarësisht se vijnë nga lista shumëerore të PD dhe LSI deputetët e rinj do duhet të qëndrojnë jashtë grupeve parlamentare, pasi që të bëhen pjesë e grupit të PD dhe LSI duhet të bëjnë kërkesë të kryetarit e grupeve respektive.

SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
 Rr. "Tish Dalia", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Rr. 1, Tiranë
 Web: www.3h.al; Email: shqgj_3h@yahoo.com; cel:0692099711

Njifton shpalljen e ankandit nga dt.28.02.2019 deri ne dt. 11.03.2019 per:
 sendin e luajtshem mjete me targe DR 9619 D
 ne pronesi te Hysni Gjergji
 Cmimi fillestar eshte 800 EURO

Ankandi zhvillohet ne zryen permbarimore ne daten 11.03.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

Medar KAJJOLLI Permbarues Gjyqësor Privat me seli ne Rr. "Urani Pano" Pll.1/G, Kati-2, Tiranë, nxjerr ne shiteje ne ankand pasurite e paluajtshme si me poshte:
 - Nr.Regjistri Hipotekor 717, date 12.10.2018, me Sip.-200 m2, Zk. 3844, Lloji Dyanj Shitje Industriale, ndodhur ne Vuno, Bashkia Himare, Qarku Vlore, me vlerë 4,151,280 (Katër milion e njëqinda e pesëqindë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë) Lekë.
 - ne pronesi te debitorit Z. Spiro Ekonomik.
 Shitja e pasurive te paluajtshme do te behet (Zhvillohet) ne date 11.03.2019, ditën e Hënë, ora 16.00 ne Zryen e Permbaruesit Gjyqësor Privat Z. Medar KAJJOLLI, ne Adresen Rrugën "Urani Pano", Pll.-1/G, Kati-2, Tiranë.

Per informacione mund te kontaktoni
 Nr.Tel:+355 66 20 333 03, ose ne Adr.-email:medar.kajjoli@yahoo.com

NJOFTIM ANKANDI
 Përmbarusi Gjyqësor Privat Neritan Çuko, në datën 20.03.2019 ora 16:00 zhvillon ankandin e Pate, për shiten e pasurisë së paluajtshme të llojit "Apartment me siperfaqe 65 m2, me numër pasurie 410/168/ND-1-19, ne volum 1, faqe 110, hyrja 1, apartamenti 19, ne zonen kadastrale nr. 2832, ne Orikum ,Vlore, ne pronesi te Albert Sali Troqe, me debitor Tonin Troqe.
 Çmimi fillestar me te cilin fillon ankandi është EUR 23.200 (njetzet e tremije e dyqind euro).
 Për çdo informacion mund të kontaktoni: Cel: Neritan Çuko: 0686065334; E-mail: neritancuko@gmail.com.

Skanimi i koncesioneve të HEC-ve

MIE: Në sitë 54 dosje, 8 me probleme të mëdha

Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë ka bërë të ditur sot rezultatet e para të procesit të skanimit të kontratave koncesionare të hidrocentraleve, një nismë kjo e njoftuar në fund të janarit. Zvëndësministri Hantini Bonati në një dalje para mediave bëri me dije se janë të paktën 54 dosje të marra në analizë deri më tani, nga të cilat 8 prej tyre kanë rezultuar me shkelje të mëdha. "Aktualisht kanë kaluar procesin e skanimit 54 dosje, 8 prej të cilave kanë rezultuar me probleme të mëdha dhe shkelje të kushteve kontraktuale, për të cilat do të fillohet procedura për ndërprerjen në mënyrë të njëanshme të kontratës. Ndër problematikat kryesore të konstatuara nga kontrolli i deritanishëm mund të përmendim mosre-

KONTRATA

Në total deri më sot janë nënshkruar gjithsej 201 kontrata koncesionare, nga të cilat 3 janë zgjidhur, që do të thotë janë 198 kontrata koncesionare për ndërtimin e 556 hidrocentraleve. Numri i këtyre të fundit pritet që të ulët në 175 kontrata koncesionare dhe 405 hidrocentrale, pasi ministria është në fazë zgjidhjeje për 23 kontrata koncesionare.

spektimin e afateve kohore procedurale, mosrespektimin e kushteve dhe kriterëve në kontratat dhe lejet e lëshuara (qofshin të aspektit ndërtimor, mjedisor, financiar etj.). Në vëmendje të analizës sonë janë jo vetëm problematikat

që janë rezultat i jokorrektësisë nga ana e subjekteve, por edhe problematikat që janë shkaktuar nga burokracia procedurale e ndjekur nga institucionet publike. Ndërprejra e kontratave është një proces kompleks dhe nga ana

e ministrisë po procedohet në mënyrë të kujdesshme që të mos ketë rrisje dhe pasojë financiare për buxhetin e shtetit", tha Bonati. Ai theksoi se në këtë proces skanimi, Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë po bashkëpunon edhe me institucione të tjera për hallka procedurale që këto të fundit janë të përfshira në proces. "Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë, si një ndër aktorët kryesorë dhe si iniciues i procesit të skanimit, po vijon punën për monitorimin dokumentar edhe në terren. Në këtë proces kompleks,



strukturat e ministrisë janë duke bashkëpunuar ngushtësisht dhe me institucione të tjera publike, ndër më kryesorët mund të përmendim: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, e cila sipas fushës së saj të përgjegjësisë po verifikon

vlefshmërinë e lejeve mjedisore për këtë tipologji aktivitetesh, nëse këto veprimtari cenojnë zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës, sikurse edhe nëse subjektet kanë zbatuar dhe përbushur me përpikmëri kushtet e përcaktuara në lejet mjedisore; Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, i cili po verifikon zbatimin e lejeve të ndërtimit nëse këto ndërtime janë kryer në respektim të përcaktimeve të lejeve zhvillimore që gëzojnë. Agjencia Kombëtare e Burimeve Ujore, e cila po verifikon vlefshmërinë e lejeve për përdorimin e burimeve ujore. Verifikimet në terren po bëhen në prezencë të përfaqësuesve të subjekteve, ndërsa përsa u përket verifikimeve dokumentare me subjektet do të vijohet të komunikohet nëpërmjet korrespondencave zyrtare", tha Bonati.

Masa, 0.06% kamatë për çdo ditë vonesë në pagesën e detyrimit

Tatimet: Gjoha kur plotësoni gabim deklaratën tatimore

Shembujt për plotësimin e faturës dhe llogaritjen e gjobës

Tatimpaguesit që dorëzojnë një deklaratë tatimore të pasaktë gjobiten me 0.06% të shumës së detyrimit të paguar për çdo ditë, gjatë sisë cilës pagesa nuk është kryer. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka publikuar edhe informacionet e nevojshme lidhur me plotësimin e deklaratës tatimore si dhe kur parashikohet gjobë në rast shkeljesh. Kjo e fundit quhet e pasaktë kur nuk është plotësuar me të dhënat reale financiare të subjektit. Sipas DPT-së, në asnjë rast gjoha nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 1 vit. Në raste kur pasaktësia është bërë me dashje dhe kjo provohet bazuar në dokumentacione e fakte, kjo sipas Administratës Tatimore quhet evazi-

NJOFTIMI

Nëse tatimpaguesi dorëzon një deklaratë tatimore të pasaktë, dënohet me një gjobë të barabartë me 0.06% të shumës së detyrimit të paguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në një njoftim të fundit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve bën të ditur se si duhet vepruar kur plotësoni gabim deklaratën tatimore. Në asnjë rast - sqaron DPT - gjoha nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Shuma e paguar e detyrimit tatimor është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor, që duhet paguar dhe shumës së tatimit të paguar. Një deklaratë tatimore quhet e pasaktë kur nuk është e plotësuar me të dhënat reale financiare të subjektit. Deklarata tatimore do të konsiderohet e saktë kur detyrimi tatimor ose teprica kreditore është llogaritur në mënyrë korrekte dhe për të cilën nuk është bërë asnjë gabim aritmetik ose logjik. Nëse pasaktësia është bërë me dashje dhe kjo arsyetohet dhe provohet bazuar në dokument-



acione, fakte dhe rrethanat konkrete, atëherë nga Administrata Tatimore do të konsiderohet evazion. Tatimpaguesi, i cili nuk mban regjistrat dhe dokumentacionin tatimor, të kërkuar sipas ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, detyrohet të paguajë një gjobë me 10,000 lekë, për çdo shkelje, në rastet kur është klasifikuar si biznes i vogël dhe me 50,000 lekë për çdo shkelje në rastet kur është klasifikuar si lloj tjetër biznesi.

SHENBULL

Në muajin dhjetor tatimpaguesi konstaton se ka harruar të regjistrojë në Librin e Shitjeve të TVSH dhe të deklarojë në FDP-në e muajit shtator, një faturë me vlerë të tatueshme 10,000 lekë dhe TVSH të llogaritur 2,000 lekë. Në këtë rast tatimpaguesi do të dorëzojë një deklaratë të re për periudhën tatimore shtator, ku të ketë reflektuar gabimin e sipërpërmendur. Në të njëjtin moment, tatimpaguesi paguan diferencën e paguar, pra 2,000 lekë TVSH, si dhe kamatëvonesë për këtë shumë.

Vonesat e avionëve, 1200 kompensime në proces

Muaji shkurt, pavarësisht se konsiderohet si ndër më të qetët për shkak të uljes të volumit të pasagjerëve, regjistrori probleme me vonesat, sidomos të disa kompanive ajrore që operojnë fluturime drejt Italisë, sipas buletinit mujor të Autoritetit të Aviacionit Civil. Nga të dhënat zyrtare që vijnë nga sektori për të drejtat e pasagjerit, rezulton se numrin më të lartë të vonesave për këtë muaj vijon ta ketë kompania "Fly Ernest", që zhvillon disa fluturime ditore me Italinë. Nga të dhënat rezulton se kjo kompani ka regjistruar 7 vonesat e kaluar e kaluar, disa prej të cilave mbi 3 orë dhe deri në mbi 7 orë. Kompanitë e tjera nuk kanë regjistruar probleme, kjo e lidhur edhe me numrin e ulët të pasagjerëve që kërkojnë të udhëtojnë. Kompania e dytë me problematike është "Adria Airways", e cila ka anuluar një fluturim. Ndërkohë që kompania tjetër që operon me Italinë "Blue Panorama", ka regjistruar vetëm një vonesë përgjatë muajit të kaluar. Numri i kompensimeve për muajin shkurt është rritur me 100 kompensime më shumë krahasuar me muajin janar. Aktualisht kompanitë ajrore kanë kompensuar me rreth 250 euro ose me bileta, rreth 800 pasagjerë që kanë plotësuar formularët e ankimit për shkak të vonesave apo anulimit të fluturimit të tyre. Pritet që në total numri i kompensimeve të rritet edhe më shumë, pasi rreth 1200 formularë të tjerë ankimi janë pranuar nga kompanitë ajrore dhe janë në proces mbylljeje. Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar përsërit apelin ndaj gjithë pasagjerëve që kanë plotësuar formularët dhe i kanë dorëzuar, në mënyrë që të përfitojnë 250 euro kompensim, të komunikojnë me kompanitë që kanë plotësuar formularët sepse është i nevojshëm verifikimi ose dërgimi i dokumenteve të nevojshme. Në rastet se ata do të hasin probleme, të kontaktojnë sektorin e të drejtave të pasagjerit të AAC në numrat e telefonit ose e-mail. Nga të dhënat zyrtare, kompania që respekton të drejtën e pasagjerëve për kompensim mbetet "Blue Panorama". Ndërsa, më problematike mbetet kompania "Fly Ernest" me vetëm 96 të tilla, ndërkohë që renditet si kompania më problematike me numrin më të lartë të vonesave dhe anulimeve të fluturimeve. Kompania "Wizz Air", gjithashtu ka kompensuar një numër të konsiderueshëm pasagjerësh të kompensuar, duke shkuar në 74, pavarësisht se renditet ndër kompanitë më serioze në respektimin e orareve.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Sigurimi i koleksioneve të muzeut të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,515,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallil", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyshesme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në logarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përsëkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Sigurimi i koleksioneve të muzeut të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 28 Mars 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Policia: Si e kthyen shtëpinë në laborator droge "Loli Verës" dhe "Pipo"

Zbulohet dhe shkatërrohet grupi kriminal që tregtonte heroinë e kokainë në Tiranë

Arrestohen 2 persona, procedohen 3 të tjerë

TIRANË

Zbulohet dhe shkatërrohet një grup kriminal që tregtonte heroinë dhe kokainë në Tiranë. Policia e kryeqytetit në bashkëpunim me prokurorinë, pas një hetimi me metoda speciale finalizuan dje operacionin e koduar "Laboratori". Mësohet se pjesë e këtij grupi ishin pesë persona. Ndërkohë, burime zyrtare nga policia bënë me dije se ka vënë në pranga shtetasit F.N., 30 vjeç, i dënuar më parë, për veprën penale të "Prodhim dhe shitje narkotikësh", dhe P.P., 27 vjeç, banues në Tiranë. Ndërsa u proceduan penalisht për veprën penale "Moskallëzim Krimi", shtetasit: B.N., 36 vjeç, B.S., 43 vjeç dhe G.G., 47 vjeç, i dënuar më parë për "Prodhim dhe shitje narkotikësh". Sipas burimeve të mësipërme, koka e



Materialet e sekuestruara nga policia

grupit kriminal dëshohet se ishte shtetasi F.N., i njohur ndryshe me pseudonimin "Loli Verës", i cili në bashkëpunim me persona të tjerë, si P.P. me pseudonimin "Pipo" shisnin në formë dozash dhe në sasi të konsiderueshme lëndë të dyshuar heroinë dhe kokainë. Po të njëjtat burime

pohuan se këta dy persona shitjen e lëndës narkotike heroinë dhe kokainë e bënin në disa zona të Tiranës. Për këtë aktivitet kriminal personat kishin përshtatur një apartament për përpunimin, përzierjen, ambalazhimin, e lëndës narkotike dhe me pas ua shisnin klientëve në doza

të vogla. Në momentin e ndërhyrjes, shtetasve F.N. dhe P.P. gjatë kontrollit fizik policia u ka gjetur dhe sekuestruar lëndë narkotike në formë dozash, ku më pas kontrolli ka vijuar në banesa ku gjithsej janë gjetur e sekuestruar rreth 1 kg e 864 gr heroinë (nga kjo sasi një



Çifti i moshuar u dhunua barbarisht në banesë, dyshohet për konflikt familjar

DURRËS - Një çift të moshuarish kanë rënë pre e dhunës brenda banesës së tyre në lagjen 15, në Spitalë të Durrësit, e për pasojë janë plagosur rëndë mbrëmjen e së hënës. Mësohet se dy të moshuarit me mbiemër Ymeri me origjinë nga Pogradeci, banorë në Spitalë janë dërguar në spitalin e Traumës. Ata jetonin vetëm, pasi fëmijët i kishin në Greqi. Ndërkaq, policia tha se nuk i mori dot në pyetje, pasi dolën nga operacioni, pasi ishin të traumatizuar dhe nuk flisnin dot. Referuar burimeve nga grupi hetimor, dyshohet që një person i ka goditur në kokë të dy të moshuarit. Më parë u ka fukur dritat e shtëpisë dhe më pas u ka hyrë në banesë ku i ka dhunuar. Nga hetimet e kryera rezultoi se autori nuk ka grabitur asgjë. Dyshimet janë që autori mund të ketë konflikt me familjarët ose fëmijët e çiftit. Policia po heton në pistën e një konflikti familjar, por nuk përjashtohet pista e ngatërimit të shënjestrës. Sipas të dhënave të moshuarit nuk rezultojnë me konflikte në lagje.

pjesë ishte e përgatitur në 353 doza), 202 gr kokainë, rreth 50 mijë lekë, peshore elektronike, frulator grirës, sitë e sende të tjera që shërbenin për përzierjen dhe ambalazhimin e lëndës narkotike. Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë

Tiranë për veprime të mëtejshme hetimore të mëtejshme për veprat penale: "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike në bashkëpunim" në ngarkim të shtetasve F.N., P.P., si dhe për "Moskallëzim krimi" në ngarkim të shtetasve B.S., B.N. dhe G.G.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

**PEST MONITORING AND CONTROL FOR PREMISES (3D SERVICE)
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k (TIA) is requesting offers for pest monitoring and control for premises (3D Service).

TIA is looking to contract a company to undertake these services that will consist in general terms of: Pest monitoring and control service for disinfection, disinsection and deratization (3D) service and to maintaining a good level of hygiene, very good sanitary conditions, healthy and clean environment, safe operational premises, in order to prevent as well the spread of the infection or contamination and any animal hazard within TIA premises.

To participate in this process interested parties will need to submit their interest for participation by e – mail, to all below e – mail address, until 20 March 2019.

Upon receipt of the e – mail, TIA will send to the respective company a Confidentiality Commitment form.

The interested company will need to send the signed and stamped Confidentiality Commitment form, by e-mail, at all the e – mail address below, and only then they will receive all the necessary forms and instructions for participating in this tender.

The set of tender documents will be delivered free of charge, via e-mail.

Offers need to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked "PEST MONITORING AND CONTROL FOR PREMISES (3D SERVICE)"
The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs. on 20 March 2019.**

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
ialmema@tirana-airport.com; fvjoka@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com

Tirana International Airport SHPK
Tirana International Airport Nënë Tereza, Administration Building, Rinas, Tirana, Albania
Phone: 00355 4 2381 600 Fax: 00355 4 2381 545
E-mail: info@tirana-airport.com Website: www.tirana-airport.com

Njoftim i kompanisë Vodafone Albania Sh.A.

Të nderuar Klientë,

Vodafone Albania Sh.A. ju njofton se duke filluar nga data **8 Mars 2019**, do të ofrojë dy plane të reja tarifore me vlefshmëri mujore për pajtimtarët me postpagesë si më poshtë:

	NEXT X	NEXT X Business
Pajtimi mujor (me TVSh)	800 Lekë	800 Lekë
Internet	400 MB	400 MB
Minuta Kombëtare	400	400
SMS Kombëtare	400	400

Plani tarifar **Next X** do të jetë i vlefshëm për individ. Plani tarifar **Next X Business** do të jetë i vlefshëm për biznese. Planet tarifore të përmendura më sipër ju ofrohen klientëve të rinj dhe atyre të cilët do të rinovojnë kontratën e tyre në dyqanet Vodafone.

Për më shumë informacion, vizitoni dyqanet Vodafone ose kontaktoni Falas Shërbimin e Klientit në 140.

Shënim me rëndësi:

Ju bëjmë me dije se në njoftimin e kompanisë Vodafone Albania Sh.A., datë 01.03.2019, 02.03.2019, 03.03.2019 është bërë një gabim shtypi në vlerën e pajtimtarit mujor për dy paketat e reja **Next**. Paketa **Next X** si dhe Paketa **Next X Business** kushtojnë **800 Lekë** (tvsh përfshirë).

Vendimi, "Arrest Shtëpie" për 1 nga kontrollorët, 5 të tjerë me "Detyrim Paraqitje"

U arrestuan për korrupsion e shpërdorim detyre, gjykata liron 6 policët në portin e Durrësit

Policia: Merrnin ryshfet për kalimin e personave me probleme në zonën "Shengen"

DURRËS

Gjykata e Shkallës së Parë e Durrësit dje ka liruar 6 efektivet e portit të këtij qyteti, të cilët u arrestuan katër ditë më parë me akuzën se merrnin deri në 1 mijë euro për të kaluar ilegalisht në zonën "Shengen" persona që kishin probleme me ligjin. Ata u prangosën nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme (SHÇBA) për korrupsion pasiv e shpërdorim detyre. Në fund të seancës gjyqësore për, togat e zeza të qytetit bregdetar vendosën masën e sigurisë "Arrest shtëpie" për efektiven Greta Batusha si dhe masën "Detyrim paraqitje" për Durim Zeka, Arjan Gjyzeli, Dorina Doganaj, Gëzim Çaça dhe Julina Kurraj. "Gjatë ndjekjes së këtij procedimi janë aplikuar metodat speciale të hetimit, ku rezultat u provuar vepërimitaria e kundraligjshme e këtyre punonjësve të policisë, të cilët, në këmbim të vlerave të ndryshme monetare, bënin të mundur kalimin e paligjshëm të personave me probleme, apo kategorisë së shtetasve që nuk u lejohej udhëtimi në zonën "Shengen", - thuhet ndër të tjera në njoftimin e policisë për arrestimin.

VENDIMI I GJYKATËS

1. Të vleftësoj të ligjshëm arrestimin në flagrancë dhe vendosjen e masës së sigurimit personal atë të "arrestit në shtëpi" të shtetasës Greta Batusha, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga neni 259 të Kodit Penal.

Ajo duhet të qëndrojë në banesën e saj dhe nuk mund të largohet prej saj pa lejen e prokurorit. Zbatimi i kësaj mase duhet të kryhet nga oficeri i policisë gjyqësore përkatës në këtë çështje.

2. Të vleftësoj të ligjshëm arrestimin në flagrancë dhe vendosjen e masës së sigurimit personal atë të "Detyrim paraqitje para policisë gjyqësore" të shtetasit Durim Zeka, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga neni 259 të Kodit Penal. Ai duhet të paraqitet të hënën e parë e të tretë të çdo muaji nga ora 11.00-12.00.

Urdhërohet lirimi i tij i



Gjykata e Durrësit

ARRESTIMI

Të dielën, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme ka arrestuar 6 punonjës të Policisë në Pikën Kufitare në Durrës për korrupsion pasiv e shpërdorim detyre. Ata akuzohen se kanë kaluar ilegalisht persona me probleme që nuk i lejohej udhëtimi në zonën "Shengen" kundrejt shumë monetare. Gjatë kontrollit, punonjësve të policisë iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale sasi vlerash monetare në lek dhe euro që dyshohet se janë përfituar në mënyrë të kundraligjshme dhe korruptive gjatë ushtrimit të detyrës.

menjëhershëm, në rast se nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale.

3. Të vleftësoj të ligjshëm arrestimin në flagrancë dhe vendosjen e masës së sigurimit personal atë të "Detyrim paraqitje para poli-

cisë gjyqësore" të shtetasit Arjan Gjyzeli, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga neni 259 të Kodit Penal. Ai duhet të paraqitet

të hënën e parë e të tretë të çdo muaji nga ora 11.00-12.00.

Urdhërohet lirimi i tij i menjëhershëm, në rast se nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale.

4. Të vleftësoj të ligjshëm arrestimin në flagrancë dhe vendosjen e masës së sigurimit personal atë të "Detyrim paraqitje para policisë gjyqësore" të shtetasës Dorina Doganaj, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga neni 259 të Kodit Penal. Ai duhet të paraqitet të hënën e parë e të tretë të çdo muaji nga ora 11.00-12.00.

Urdhërohet lirimi i saj i menjëhershëm, në rast se nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale.

5. Të vleftësoj të ligjshëm arrestimin në flagrancë dhe vendosjen e masës së sigurimit personal atë të "Detyrim paraqitje para policisë gjyqësore" të shtetasit Gëzim Çaça, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga neni 259 të Kodit Penal. Ai duhet të paraqitet të hënën e parë e të tretë të çdo muaji nga ora 11.00-12.00.

Urdhërohet lirimi i tij i menjëhershëm, në rast se nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale.

6. Të vleftësoj të ligjshëm arrestimin në flagrancë dhe vendosjen e masës së sigurimit personal atë të "Detyrim paraqitje para policisë gjyqësore" të shtetasës Juliana Kurraj, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga neni 259 të Kodit Penal. Ai duhet të paraqitet të hënën e parë e të tretë të çdo muaji nga ora 11.00-12.00.

Urdhërohet lirimi i saj i menjëhershëm, në rast se nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës, nga e nesërmeja e shpalljes.

U shpall në Durrës, në 05.03.2019.

"Viktima kishte hematoma dhe plagë të thella në kokë"

Zbardhet krimi në familje, policia: Djali masakroi nënën me grushte e sende të forta

KORÇË - Një ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në Korçë, ku djali mbyti nënën e moshuar me duar në fytyrë, policia ka zbardhur detaje të reja në lidhje me krimin në familje. Mësohet se 84-vjeçarja Nazime Demollari, e cila u gjet e pajetë në banesën e saj, u dhunua nga i biri. Ky është konkluzioni i ekspertëve mjeko-ligjorë, raporti i të cilëve ka zbuluar se e moshuara kishte hematoma dhe plagë të thella në kokë. Gjithashtu, ajo ishte goditur në pjesë të ndryshme të trupit, të cilat janë shkaktuar nga goditja me mjete të forta.

Pas debatit verbal me të ëmën, mësohet se Nesim Demollari, në gjendje të dehur, e ka rrahur për disa minuta me grushte dhe sende të forta nënën e tij. Autori i kriminit, i cili u arrestua në kushtet e flagrancës, ka mohuar gjatë marrjes në pyetje vrasjen e të ëmës, duke deklaruar se ajo ishte rrëzuar vetë dhe për pasojë kishte humbur jetën. Por, një tjetër fakt që e ka tradhtuar 64-vjeçarin është një telefonatë që ai ka kryer me vëllain e tij. Gjatë bisedës, ai i thotë lajmin e kobshëm se kishte vrasur nënën, ndërsa para hetuesve, ai vazhdon të mo-

hojë autorësinë, duke mos treguar motivin e ngjarjes së rëndë. Ndërkaq, fqinjët e familjes Demollari u shprehën pas ngjarjes për "Gazeta SHQIPTARE" se ishin në dijeni të problemeve të vazhdueshme të nënës me djalin. Sipas tyre, Nesim Demollari ishte divorcuar nga gruaja dhe që pas ndarjes jetonte me nënën e moshuar. I pakëndës dhe pa asnjë të ardhur, 64-vjeçari i ishte dorëzuar pjesë dhe grindjet me nënën e tij ishin të përvitshme. Fqinjët kanë dëgjuar herë pas here debate mes tyre. Dyshimet se krimi mund të ketë ndodhur për çështje pronësie nuk janë pistë hëti-



mi e policisë, pasi familja Demollari është e varfër dhe nuk ka prona. Autori Nesim Demollari njihet nga komshinjtë si një njeri problematik dhe mbi të gjitha përdorues i pijeve alkoolike. "Nesimi dhunonte sistema-

SHKURT

Arrestohet "tutor" i prostitutave, i dënuar me 14.4 vite burg në Itali

TIRANË - Një 49-vjeçar, i cili ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet italiane është prangosur dje nga policia e Tiranës. Bëhet fjalë për shtetasin Mentor Koltraka, i cili do të ekstradohet në vendin fqinj. "Forca e Operacioneve Speciale dhe Kërkimit në D.V.P. Tiranë në bashkëpunim me Interpol Tiranë arrestuan shtetasin shqiptar të shpallur në kërkim ndërkombëtar, Mentor Koltraka, 49 vjeç, banues në Tiranë. Autoritetet italiane kanë lëshuar ndaj këtij shtetasi urdhër arresti ndërkombëtar në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit në Firence, Itali, e cila e ka dënuar këtë shtetas me 14 vjet e 4 muaj e 5 ditë burg, për veprën penale "Shfrytëzimi i prostitucioni", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Kapet në Kakavijë polaku i dyshuar

SI VRASËS ME PAGESË GJIROKASTËR - Policia e Kakavijës ka shoqëruar dje një shtetas polak me identitet të rremë, i cili dyshohet të ketë gisht në një vrasje të kryer në kryeqytetin e Greqisë, Athinë. Policia Shtetit menjëherë ka nisur punën për të zbardhur vepërimitarinë e të ndaluarit në pikën kufitare. Shtetasi i huaj, i cili dyshohet të jetë polak po ikte nga Shqipëria në Greqi duke përdorur një pasaportë false, por është pikasur nga autoritetet doganore. Sipas të dhënave të para nga dikastieri i rendit, dyshohet se i ndaluarit është një vrasës me pagesë dhe i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpoli.

BOTIMI

Nga ndërtimi i linjës hekurudhore të parë në Shqipëri, Shkodër-Berat, te çelja e më tepër se 231 shkollave shqipe, krijimi i Komisionit Letraro Shqipe, censusi i parë gjithëpërfshirës shqiptar...

Dëshmitë kulturore austriake në Shqipëri në një libër

Fatmira Nikolli

Monarkia Austro-Hungareze dhe Shqipëria në vitet 1916-1918", ka qenë titulli i një konference shkencore të mbajtur në Tiranë vitin e shkuar. "Historia e plotë e njerëzimit do të shkruhet atëherë kur shqiptarët të marrin pjesë në shkruarjen e saj". Johann Sattler, ambasadori i Republikës Federale të Austrisë në Shqipëri zgjedh këtë fjalë të Maximilian Lambertz për të nisur parathënien e botimit që përmbledh kumtesat e mbajtura atëkohë. Lambertz ishte një nga albanologët austriakë më të njohur, që në 1916-1918 ishte studiuesi i vetëm i huaj anëtar në "Komisionin Letraro Shqipe". Kjo e fundit që "takimi" i parë që dha një ndihmesë të madhe në unifikimin e gjuhës shqipe.


Kumtesat / studimet e një viti më parë përmbledhen dhe botohen në kuadër të Vitit Kulturor Austri-Shqipëri 2018 dhe vijnë si rezultat i një bashkëpunimi intensiv midis ambasadës austriake Tiranë, Ministrisë së Jashtme në Vjenë, Ministrisë shqiptare të Kulturës dhe Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë.

"Kjo përmbledhje artikujsh shkencorë, mund të cilësohet në këtë drejtim si një kontribut në shkruarjen e historisë së njerëzimit, sepse në të kanë kontribuar profesorë historie, historianë të ushtrisë, arkeologë, studiues të muzeologjisë, studiues të gjuhësisë, politologë, albanologë nga Shqipëria dhe Austria. Këto kumtesa përbëjnë një interes të veçantë për lexuesin, pasi ato nuk paraqesin vetëm zhvillimin historik të ngjarjeve, por shkojnë përtej kësaj aspekti, duke kontekstualizuar edhe influencën e zhvillimit administrativ, atij edukativ dhe shkencor, por edhe politik-social në organizimin e mëvonshëm të shtetit shqiptar", thotë Johann Sattler.

KUJTIME E VEPRË

Sipas ambasadorit, për sa më sipër, mund të përmenden ndër të tjera shembuj si, ndërtimi i linjës hekurudhore të parë në Shqipëri (nga Shkodra deri në Berat), çeljen e më tepër se 231 shkollave shqipe, krijimi i Komisionit Letraro Shqipe, censusin e parë gjithëpërfshirës shqiptar etj. Ai kujton se gjatë administratës ushtarake austro-hungareze në Shqipëri, institucionet administrative, ushtria, infrastruktura, gjithashtu, edhe gjuha shqipe përjetuan një hov modernizimi. "Megjithatë, flasim për kohëra lufte dhe pushtimi, të cilat përshpërndajnë zhvillimet e veta edhe shumë ngjar-

1916-1918, trashëgimia e një monarkie përmes gjurmëve që la pas



je negative që ndodhin zakonisht në kohëra të tilla. Prandaj në këtë botim janë përfshirë edhe këta elemente, të cilat trajtohen nga këndvështrime të ndryshme historike. Në këtë mënyrë, ky libër na jep një vështrim gjithëpërfshirës mbi ngjarjet në vend - nga Shkodra deri në Vjosë - për periudhën kohore 1916-1918 edhe më pas", nënvizon Sattler. Ai falënderon në mënyrë të veçantë autorët e këtij libri, për kumtesat e tyre jashtëzakonisht interesante: Paskal Milo, Tamara Scheer, Marenglen Kasmi, Valentina Duka, Kurt Gostentschnigg, Proletar Hasani, Beqir Meta, Ledia Dushku, Ilir Kalemaj, Enriketa Pandlejmonji (Papa), Erëin A. Schmidl, Gentiana Kera, Anila Omari, Aljula Jubani, Bendis Kraja, Izer Maksuti, Rovena Vata, Luan Përzhita, Dorian Koçi and Skënder Bushi. Dhe kujton edhe se ekziston një këngë tipike shqiptare për feldbanin (hekurudhën) e kësaj kohe: "Tu thefshin rrotat ty o feldban, që na i more gocat, nga Berati na i çove ne Elbasan". Një tjetër falënderim i shkon (ish)ministres shqiptare të Kulturës, Mirela Kumbaro Furrhi dhe stafit të saj për bashkëpunimin aktiv në organizimin e shumë aktivitetëve gjatë këtij viti të ngjar-

shur kulturor. Më tej ai ndalet te kontributi i drejtorit të Muzeut Kombëtar, Dorian Koçi si dhe historiani Marenglen Kasmi për koordinimin gjithëpërfshirës të ekspertëve dhe përzgjedhjen e fotografive për ekspozitën, si dhe për çfaqjen e librit. Botimi i këtij vëllimi në gjuhën gjermane u mundësua përmes punës profesionale të zonjës Greta Andoni dhe zotit Florian Doschek, të cilët morën përsipër përkthimin dhe redaktimin e tij. Duke pasur parasysh marrëdhënien shqiptaro-austriake ende sot, ambasadori austriak falënderon edhe shqiptarët dhe austriakët e panumërt, të cilët përçuan kujtimet e asaj kohe, qoftë gojarisht apo edhe në mënyrë të shkruar, duke kontribuar kështu në ruajtjen e memories kolektive. "Si përfaqësues i Austrisë në Shqipëri në bukur, kudo ku jam ndodhur, qoftë në Shkodër apo në Tropojë, në Vlorë apo në Berat, më tregohet për lidhjen e hershme mes vendeve tona. Kjo është një mirënjohje për çfarë është bërë ndër shekuj, dhe akoma më tepër një detyrë për ta zgjeruar në të ardhme këtë ndërthurje të larmishme të marrëdhënieve tona". e mbyll parathënien ambasadori.



Johann Sattler, ambasadori i Republikës Federale të Austrisë në Shqipëri



Drejtori i Muzeut Kombëtar, Dorian Koçi

HISTORIA E STUDIMET

Nga ana tjetër, historiani Dorian Koçi vëren se raporti i "Austro-Hungarisë dhe Shqipërisë në vitet 1916 - 1918", është një etapë e historisë së Shqipërisë, ndonëse e shkurtër në kohë, është e mbushur me ngjarje e procese të ndërlikuara të karakterit politik, ekonomik - shoqëror e kulturor dhe si rrjedhojë krijon ndjeshmëri jo vetëm në mesin e studiuesve, por edhe në opinionin publik. Sipas Koçit, periudha kohore midis viteve 1916 - 1918 përkon me një pjesë të historisë së shtetit të pavarur shqiptar dhe njëkohësisht me atmosferën mbytëse që krijoi Lufta e Parë Botërore (1914 - 1918), veçanërisht në kushtet e një shteti të vogël të sapokrijuar. "Siç dihet edhe nga historia, territori shqiptar do të shndërrohej në shesh të luftës botërore në fillim të vitit 1916, me shtrirjen këtu të forcave të bllokut qendror, ku bënte pjesë Austro - Hungaria dhe Bullgaria, dhe ballafaqimin e tyre me bllokun e Antantës", thotë historiani. E shton se, është një periudhë që karakterizohet nga manifestimet nacionaliste, veçanërisht midis shteteve fqinje, të cilat morën formën e luftës së armatosur, të shoqëruar me aneksim terrirosh në dem të shtetit shqiptar. Për Koçin, në kontekstin e trazirave të luftës, të mosmarrëveshjeve të brendshme, të përpjekjeve qoftë të karakterit diplomatik dhe me anë të luftës për mbrojtjen e kufijve, etj., marrëdhëniet midis dy vendeve

shfaqën edhe përpjekje për të rigjallëruar disa aspekte të tjera të jetës, siç ishte kultura dhe shkencën. Në këtë kuadër, larmia e ngjarjeve që gjenerojnë marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Austro - Hungarisë midis viteve 1916 - 1918, është mjaft e madhe pavarësisht kufizimit në kohë të tematikës së konferencës. Dr.Dorian Koçi nënvizon se pikërisht, natyra dhe intensiteti i raporteve të tyre, jo vetëm në fushën politike diplomatike, por duke prekur dhe trajtuar fusha të ndryshme të impaktit apo influencës, si zhvillimet kulturore, arsimit, shkencën, arkeologjinë, muzeologjinë dhe gjuhësinë, bënë bashkë studiuesit, të cilët ndan rezultatet e tyre në fushat që ata përfaqësojnë.

"Si organizatorë dhe vendpriftës i aktivitetit Muzeu Historik Kombëtar u përpoq ta ndajë konferencën në sesione që trajtojnë çështje të historisë, si politika e Austro - Hungarisë ndaj Shqipërisë, roli i forcave ushtarake shqiptare, qëndrimi i Austro - Hungarisë ndaj Shqipërisë gjatë Luftës së Parë Botërore; një tjetër seancë ju dedikua impaktit të Austro - Hungarisë në arsim, kulturë dhe në gjuhën shqipe, ndërsa një seancë e veçantë ju kushtua arkeologjisë dhe muzeologjisë, ku u parashtrua roli i austriakëve në fushën e identifikimit dhe humlumimit të monumenteve dhe vendbanimeve arkeologjike, por edhe një pjesë nga koleksioni i objekteve që u zbuluan gjatë kërkimeve të tyre", e mbyll Koçi fjalën e tij.

PROJEKTET

Nga shtëpia e Abatit te kalaja e Skënderbeut, propozimet për diasporën

Fatmira Nikollë

Muzeu i diasporës" do të jetë projekti më i ri i Ministrisë së Kulturës. Lajmi është bërë i ditur nga ministrja e Kulturës, Elva Margariti gjatë Samiit të Dytë të Diasporës. Ministrja e re, u shpreh se ky muze do t'i shërbejë brezave të ardhshëm dhe shqiptarëve kudo që ndodhen. "Ky muze do të jetë i së ardhmes dhe jo i së shkuarës. Një muze për brezat që vijnë. Një muze që do t'u kushtohet çdo shqiptari dhe familje shqiptari, që kaloi detin qysh në kohërat e hershme dhe që do të përbëjë regjistrin e diasporës, përveç historive të saj të mëdha ose të vogla. Një muze ku me një donacion secili mund të shkruajë emrin e tij, familjes, apo kujdo që ai dëshiron" - u shpreh Margariti.

Sipas një njoftimi në faqen zyrtare, në ditë të Samiit të dytë të Diasporës, i cili u mbajt në Tiranë në datat 28 shkurt-2 mars 2019 Ministria e Kulturës shkëmbu ide, mendime dhe përvoja me përfaqësues të diasporës për çështje të trashëgimisë jomatëriale. Produktet dhe shërbimet artistike shqiptare në kërkim të zgjerimit të tregut, prezantuar nga artistanet shqiptare rrëfyer se tradita jonë e hershme e zejeve është jo vetëm traditë, por edhe mundësi punësimi, shtimi i të ardhurave dhe përmirësimi i mirëqenies së vetë zejtarëve dhe komunitetit ku punojnë. Diaspo-

"MUZEU I DIASPORËS" do të jetë projekti më i ri i Ministrisë së Kulturës



ra shqiptare krijon mundësitë për ta ruajtur, zhvilluar dhe përhapur këtë traditë në të katër anët e botës, duke dëshmuar kështu për pasuritë e rralla të zejeve shqiptare. Ajo prezantoi edhe programin "100 Fshatrat", një program ku bashkëjetojnë trashëgimia dhe agroturizimi si një mundësi e mirë bashkëveprimi me diasporën. "Programi për 100 fshatrat është një bashkim jo vetëm nevojash por dhe forcash për të ecur përpara" - u shpreh Margariti.

PROPOZIMI

Ministrja e Kulturës, në pëllëmbë të modelit e suksesshme të filantropisë dhe mundësitë për investim në trashëgiminë kulturore shqiptare propozoi edhe tri nga objektet e rëndësishme të

trashëgimisë kulturore, që kërkojnë mbështetje e diasporës, sa i përket vlerës historike dhe arkitektonike të tyre.

Së pari, ajo foli për Muzeun Kombëtar të Arsimit. Mësonjëtorja e Parë Shqipe në Korçë nisi të kryejë funksionin e saj më 7 mars 1887, si shkolla e parë laike shqipe. Banesa ku u hap Mësonjëtorja është ndërtuar rreth vitit 1840 dhe ndodhet në bulevardin që mban emrin e "Shën Gjergjit". Aktualisht në këtë ndërtesë është vendosur "Muzeu Kombëtar të Arsimit", që rrfen rrugëtimin e arsimit kombëtar shqiptar në të gjithë epokat.

Më pas ajo përmendi atë që njihet si "Shtëpia e Abatit". Në Shkodër gjendet ndërtesa dykatëshe e njohur si "Shtëpia e



Abatit" ose selia e shoqërisë "Bashkimi". Kjo ndërtesë, tashmë në gjendje të rrënuar, në janar të vitit 1899 u bë seli e shoqërisë kulturore e adhetare "Bashkimi", falë së cilës gëzojmë sot alfabetin e gjuhës shqipe. Në shoqërinë "Bashkimi" të themeluar prej Dom Preng Doçit, kanë dhënë ndihmesë të çmuar emra të shquar si: At Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Dodë Koleci, Dom Ndoc Nikaj, Anton Xanoni, Im-

zot Jak Serreqi, Imzot Lazër Mjedina, etj.

Dje së treti, ajo kërkoi ndihmë për kalanë në Kepin e Rodonit. Pas Kuvendit të Lezhës më 1444, Skënderbeu u kujdes për riparimin dhe pajisjen e kështjellave, që kishte në zotërim. Ai i kushtoi një rëndësi të veçantë mbrojtjes natyrore të kështjellave. Shembull i kësaj natyre është dhe Kalaja në Kepin e Rodonit, që njihet si Kalaja e Skënderbeut.

Amundet një festival letërsisë të përçojë mesazhe ambientaliste apo natyraliste, apo më tej edhe atdhedashurie; sigurisht përderisa kritika lëvdon romanet e rinj të pagëzuar "Fiction Klima" dedikuar natyrës, lëvizjeve ambientaliste dhe luftës për mbrojtjen e mjedisit. Eh ja, sikur Naimi dhe Dritëroi ta dinin që vargjet e tyre do të kategorizoheshin një ditë si kjo e sotmja si Luftëtarë Mbrojtës të Planetit, nuk do t'i kishin rështur vargjet. Vjen si propozim i Klik Ekspo Group & Tirana International Fair, Festivali Ndërkombëtar Kulturor "Fije Bari", tërësisht sipas konceptit outdoor, me qëllim lënies hapësirë formave të reja të edukimit dhe sensibilizimit kulturor, artistik, turistik, por edhe në një këndvështrim më të ngrohtë e romantik, edukimi për dashurinë për Atdheun dhe Natyrën. Nga data 3 deri në 6 maj në Muzeun Historik Kombëtar, me pjesëmarrjen e botuesve, autorëve, përkthyesve, kritikëve të artit, studiuesve të artit, por

edhe natyrës, mjedisit, institucionëve të kulturës dhe arsimit, shkollat e mesme, universitetet, bibliotekat, libraritë dhe shpërndarësit e librit, festivali ndërkombëtar kulturor "Fije Bari", shndërrohet në një Platformë për edukim artistik, social, turistik, historik, mjedisor, gjithë sa duhen mbajtur mend e në rend të ditës për një të sotme të qetë e të ardhme të shëndetshme.

Ç'përndodh aktualisht me librin dhe leximin? Mbi 200 libra në vit mund të lexohen nëse heq dorë nga rrjetet sociale, e me gjithë një raport dekurajues statistikor, ende veprimtarët e librit, botuesit, përkthyesit, autorët e vetë lexuesit, nuk rreshtin së kërkuari forma të reja për lehtësuar e kthyer leximin në nevojë organike. Ende lexohet, qoftë në letër, libërth xhepi apo fancy, ulur apo në lëvizje, në këmbë, në parqe, në telefon. Por atëherë, pengjet, janë temat? Janë autorët? Kritikët? Ngjarjet sociale apo Koha me rrjedhën e saj. O Po sikur të ishte më e thjeshtë se kaq, dhe të mjaftonte më pak forcm për të bërë bashkë në një formulë të vetme autorin dhe lexuesin, leximin

dhe një vlerë të shtuar edukative dhe ndërgjegjëse, që për këtë herë, do të jetë, Natyra, Toka, Mjedis, në fund të fundit e ardhmja e njerëzimit, parë në një këndvështrim të lehtë për t'u perceptuar, të dashur për dëgjimin dhe shpirtin. Edicionin i shkuar të Festivalit Ndërkombëtar Kulturor "Ditënetët e librit", organizuar nën kujdesin e Ministrisë së Kulturës, erdhi si një rigjenerim fuqish të të gjithë aktorëve dhe faktorëve të librit dhe botimeve, të bërë bashkë, për të krijuar një himn ndaj mbartësit të vlerës fillestare të librit: shkrimtarit, përkthyesit, studiuesit, dhe nëpërmjet tyre, të quhej i plotë qerthulli deri tek lexuesi më i largët e i pabindur. Me orët e fundit të Festivalit "Ditënetët e librit", shifrat treguan se ishte koha që Tirana të bënte të vetin një eveniment të rëndësishëm, origjinaliteti të nismës dhe standardeve të tilla që e rreshtojnë atë kah kryeqyteteve evropiane, duke luajtur sërish "kartën e kulturës" mbi 100 personazhe e figura veprimtarë të artit dhe kulturës, mes shkrimtarëve e poetëve, autorëve, botuesve, përkthyesve, studi-

"FIJE BARI", NJË FESTIVAL NDËRKOMBËTAR KULTUROR

uesve, gjuhëtarëve, piktorëve dhe mjeshtrave të arteve pamore, librarëve e bibliofilëve, profesionistëve dhe amatorëve të fjalës; mbi 12.000 vizitore, dëgjues e ndjekës të Festivalit dhe Kalendarit të veprimtarive të përditshme e të përorëshme në mbi 90 takime e aktivitete; mbi 70 tituj të promovuar, të rinj apo të ririgjuar nga memoria e hershme; Është programuar Muzeu Historik Kombëtar dhe pjesë të sheshit "Skënderbeu" si pritës i Festivalit, si forma e hapur dhe mikpritëse më e përshtatshme për përmbajtjen "e gjelbër" dhe të lirë të festivalit, duke garantuar akses të kollajshëm për vizitorët dhe lexuesit, dhe një konfigurim të mirëprogramuar të sipërfaqeve të ekspozimit, sallave të konferencave (me tenda ekspozimi dhe ambiente të mbrojtura), skenave e pedanave open-air për takimet me autorët, pasditeve letrare, shfaqjet teatrore. Kënde të veçanta, ndarë sipas letërsisë fiction apo non-fiction, autorë të

dashur e popullorë, autorë të rinj, këndet e botimeve letrare për Natyrën dhe Mjedisin. Pa harruar, autorët non-fiction, që shkruajnë ditarë udhëtimesh, bujq të panjohur por njohës të gjuhës së tokës, ekspertë të mjedisit, shkencëtarë, pjesëmarrës në misionet humanitare apo në mbrojtje të mjedisit, Greenpeace etj. Ndonjëherë, edhe pse pa pretendime letrare, vepra të tilla falë spontanitetit ndihmojnë që të rizbulohen imazhe e vende të humbara e harruara, kultura e tradita zezesh e punimit të tokës, takim me kafshë pune a shtëpiake në lirinë e tyre natyrale. Festivali është mundësia më e mirë për thyerjen stinore të rutinës së mos-leximit, në pranverë, një rast i rrallë për lexuesit për të takuar idhujt, për autorët një mundësi për të zbritur nga "Olimpi", për botuesit, hapja e një dritareje të re për të qenë në hap me trendet e industrisë.

Portali “punëtëmbarë.al”, së shpejti do të nisë procesi tjetër i përzgjedhjes

Zbardhen emrat e 590 studentëve ekselentë, që do të fillojnë punë në administratë

Kontratë 1-vjeçare për aplikantët me mesatare mbi notën 9-të

Voltiza Duro

Të gjithë ata studentë ekselentë që aplikuan për një vend pune në institucionet e administratës shtetërore tashmë mund të njihen me pozicionet që kanë arritur të fitojnë. Gazeta Shqiptare zbardh sot listën e plotë me emrat e 590 kandidatëve fitues që u lind e drejta të punësohen në shtet për 1 vit. “Në zbatim të pikës 11, të vendimit nr. 766, datë 26/12/2018, të Këshillit të Ministrave, “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të sërëmbimit civil, për vitin 2019”, Departamenti i Administratës Publike në përfundim të proce-

durës së përzgjedhjes së pozicioneve të punës nga ana e kandidatëve të kualifikuar, njofton se kandidatët që kanë përzgjedhur vendet e punës, do të punësohen me kontratë të përkohshme 1 vjeçare në

pozicionet specialist dhe të barzaveflëshëm, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të sërëmbimit civil”, thuhet në njoftim. Procesi i përzgjedhjes në bazë të mesatares së studentëve në

zyrat e Departamentit të Administratës Publike zgjati 4 ditë, në të cilin studentët të ekselencës të arsimuar jashtë vendit apo në universitetet publike e private në Shqipëri, zgjodhën vendet e

punës që u ofroreshin në kuadër të “Paktit për Universitetin”. Në total, u ofruan 803 vende pune ku, pa konkurs dhe vetëm mbi bazën e mesatares (9.00-10.00), studentët duhej vetëm të

përzgjidhnin vendet që ishin të lira në administratë. Së shpejti do të zhvillohet edhe procesi tjetër i përzgjedhjes nga ana e studentëve të ekselencës që kanë aplikuar në portalin punëtëmbarë.al.

LISTA ME 590 E EMRAT E STUDENTEVE TË EKSELENCËS QË FITOJNË PUNË NË ADMINISTRATË

1. Perrika Alfred Gjata Dega Juridike, Dega Dega Dega Kabinete Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	SHBA OKCQ - 2018, Mesatare: 9.85
2. Ejupi Baki Sulozani Dega Juridike, Dega Dega Dega Transi Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	UKRAI ECU - 2018, Mesatare: 9.55
3. Iskenderi Lutfi Riza Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme	ITALIA ECU - 2018, Mesatare: 9.56
4. Dorontina Lutfi Riza Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	IRAFED OKCQ - 2018, Mesatare: 9.51
5. Iskenderi Lutfi Riza Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	KORÇA OKCQ - 2018, Mesatare: 9.24
6. Aida Fajfi Sulbi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	TERRI OKCQ - 2018, Mesatare: 9.18
7. Dorontina Lutfi Riza Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	HENGEL ECU - 2018, Mesatare: 9.12
8. Leffer Braho Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	GERMANIA ECU - 2018, Mesatare: 9.00
9. Leffer Braho Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
10. Artur Nini Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
11. Artur Nini Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
12. Artur Nini Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
13. Artur Nini Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
14. Artur Nini Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
15. Artur Nini Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
16. Artur Nini Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
17. Artur Nini Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
18. Artur Nini Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
19. Artur Nini Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
20. Artur Nini Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00

14. Efendi Riza Dylfari Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
15. Lindita Gjon Gjegjaj Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.00
16. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
17. Rudina Shqiponja Lamija Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
18. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
19. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
20. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
21. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
22. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
23. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
24. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
25. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
26. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
27. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
28. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
29. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00
30. Arbeni Ender Shkapi Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2017, Mesatare: 9.00

67. Aida Vladimir Laska Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.88
68. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
69. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
70. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
71. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
72. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
73. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
74. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
75. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
76. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
77. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
78. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
79. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
80. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
81. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
82. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
83. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
84. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
85. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
86. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
87. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
88. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
89. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
90. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
91. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
92. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
93. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
94. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
95. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
96. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
97. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
98. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
99. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87
100. Ena Lambi Shqeci Nëpunësues i Zëritshmërisë të Përgjithshme, Departamenti i Zëritshmërisë të Ministrave	SHQIPËRI PUBLIK - 2018, Mesatare: 9.87

VIP

Suplement
Pages

Enë mërkurë 6 Mars 2019

GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj

"BULEVARDI POLITIK"

- Dy presidentët Meta dhe Pahor shijojnë ushqimin shqiptar bio
- Berisha më në formë se kurrë, nuk i bën gjë as gazi lotsjellës
- Zgjidhja gjeniale e policisë, leu shtyllat me graso që të mos prishnin kamerat
- E bija mbush 4 vjeçe, Spiropali: M'u shfaqe në eko më e madhe se bota

Çudit me deklaratën këngëtarja: Djemtë s'më afrohen se rri me mamën



Shpati ka gjetur nusen, por nëna është kundër? Ja ç'thotë ajo



Rrëfëhet piktorja: Jam e apasionuar pas pikturës së Jackson Pollock



Stela Rustemaj:

Pikturimi me gjithë trupin, 'bëhem një' me veprën time

"Nëse s'do të pikturoja, do dija më pak për veten, do isha më e huaj ndaj asaj që jam"

Rrëfëhet piktorja: Jam e apasionuar pas pikturës së Jackson Pollock

Stela Rustemaj:

Pikturimi me gjithë trupin, 'bëhem një' me veprën time

"Nëse s'do të pikturoja, do dija më pak për veten, do isha më e huaj ndaj asaj që jam"

Pamela Aliaj

Ditët e sotme shumë njerëz janë në krye të një pune të cilën e kanë zgjedhur për të siguruar të ardhura apo edhe për të vënë në praktikë atë që për vite me radhë studiuin nëpër shkollë. Por ajo që të gjithëve na dalon është fakti se gjithkush nga ne ka pasionet dhe dëshirat e tij të cilat në një mënyrë apo në një tjetër i realizon (gjuhë njëse ka mundësi apo nëse janë mjaftueshëm të mëdha për t'u realizuar). Ndërkaq një gjë të tillë ka arritur të realizojë edhe Stela Rustemaj. Nuk mund të themi se bën një jetë të dyzuar, por një jetë të mbushur me ngjyra në kuptimin e plotë të fjalës. Ditën ajo është në krye të punës si juriste ku edhe ka përfunduar studimet, ndërsa në pasdite e deri në orët e vona ajo i përkushtohet gjysmës tjetër të saj, pikturës. Por si lindi pasioni dhe pse tani vendosi që ta sjellë në jetë? Në një intervistë për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", Stela na rrëfen pak nga bota e saj e veçantë e perceptimit të artit. "Nëse një ditë do ta gjeja veten të ndarë nga piktura unë do isha një hap më larg vetes. Piktura është pasqyra ime, është reflektim i asaj çka unë nuk shpreh dot verbalisht. Prandaj nëse një ditë nuk do të pikturoja, do të dija më pak për vetëveten, do të isha më e huaj ndaj asaj që jam", ka thënë ndër të tjera Stela. Për më tepër njihuni me pasionin e saj dhe atë që vërtetë mund t'ju frymëzojë në intervistën e mëposhtme.

Keni mbaruar studimet për ekonomi dhe juridik ndërkohë që ushtroni këtë të fundit. Cila ishte shtytja para 8 vitesh që ju beri t'i jepnit jetë pasionit për pikturën?

Unë e kam dashur pikturën që femijë, por, asnjëherë nuk kam pasur dëshirën të studioja për të. Mjaftohesha me skicat, pikturat në letër dhe në muret e dhomës. Ishte një ditë e zakonshme ajo që unë vendosa të pikturoja në telajo dhe shumë e rastësishme.

Në çfarë lloj kategorie hyn arti juaj?

Arti im është art modern, abstrakt. Është konceptual, ku gjithkush e percepton në mënyrën e vetë.

Përse në pikturat tuaja përfshini edhe trupin tuaj përveç du-



arve? Çfarë simbolike ka kjo lloj metode për ju?

Pikturimi me duar dhe trupin krijon një lidhje më organike me pikturën. Gjithashtu, është pasaporta ime në art, pra në këtë mënyrë krijoi karakterin e pikturave të mia. Heqja e kufirit midis krijuesit dhe veprës artistike lejon të "bëhem një" me veprën e artit.

A keni pasur ndonjë pikturë, e

cila është ende në studion apo shtëpinë tuaj dhe s'keni dashur aspak ta shihni? Pse?

Po, është piktura, e cila titullohet "Plagët" dhe është realizuar në një moment shumë të vështirë të jetës sime, në një moment ku dikush është ndarë nga jeta. Jam shumë e lidhur me atë pikturë.

Si i lind frymëzimi për një pikturë Stelës?

Çdo moment për mua është një



moment frymëzimi. Sigurisht që në disa momente jam më e frymëzuar e në disa më pak, por karakteri im individual më bën të gjej frymëzim nga çdokush, nga çdo gjë dhe në çdo moment. Dita më ofron shumë momente prej të cilave unë ngacmohem për t'i shprehur përmes pikturës.

Si do të ndihej Stela nëse për një moment nuk do të merrej më me pikturat e saj?

Gjithsecili nga ne është në ndryshim të vazhdueshëm. Pasioni im për piktura, jo! Nëse një ditë do ta gjeja veten të ndarë nga piktura unë do isha një hap më larg vetes. Piktura është pasqyra ime, është reflektim i asaj çka unë nuk shpreh dot verbalisht. Prandaj nëse një ditë nuk do të pikturoja, do të dija më pak për vetëveten, do të isha më e huaj ndaj asaj që jam.

A ka një pikë takimi mes pik-



Ajo s'para parapëlqen të flasë për jetën private duke u munduar ta ketë të tillë sa më shumë të mundet. Ndërkaq ka bërë përfundim në fundmi e ftuar në emisionin 'Mirage'. Këngëtarja Adelina Berisha duke qenë se është e shoqëruar shumicën e kohës me mamën e saj, gazetarja e pyeti nëse e ëma po e pengonte atë për të nisur një lidhje. Adelina u shpreh: "Shpeshherë ndjej që njerëzit nuk kanë guxim të më afrohen se kam mamin pas vetes. Por kam momente kur dal me shoqërinë. Kur të ketë diçka të re në jetën time private do e merrni vesh." Ndërkaq kujtojmë se burime të "Gazeta Shqiptare" zbuluan se ajo ishte në një lidhje me djalin e deputetit Koka, Arbri, por ajo s'ka pranuar të prononcohet lidhur me këtë gjë.



Çudit me deklaratën këngëtarja: Djemtë s'më afrohen se rri me mamin

Këngëtarja Shpat Kasapi prej kohësh është përfolur se s'është më beqar. Ai e ka gjetur gjysmën tjetër dhe për këtë foli dje në emisionin e Rudina Magjistarit, i ftuar bashkë me të ëmën, Gjylmysere Kasapi. Shpati nuk ngurroi të bënte shaka me këshillat që nëna e tij i jep gjithnjë para se të dalë në mbrëmje për t'u argëtuar. "Kur dal natën më thotë, po pse nuk rri në shtëpi. Vajzat e mira i gjen në fakultet jo në diskotekë". I pyetur nga moderatorja nëse është i dashuruar, ai u shpreh se ndihet "deri diku", pasi është në fillimet e lidhjes me një vajzë nga Kosova. "Jam deri diku. Po fillimet janë normale. Nuk ia kam prezantuar mamin". Duke qenë se nëna e këngëtarit nuk e ka takuar ende vajzën, ajo dha miratimin live në emision se tashmë është koha që djali i saj të martohet dhe të krijojë familje. Ndërsa mesazhi i fundit i nënës së tij për vajzën që i ka rrëmbyer zemrën këngëtarit është ky: "Cilado vajzë që do të jetë e dashura e Shpatit, do të jetë e dashur dhe për mua. Gjithmonë falim, gjithmonë gëzohemi dhe emocionohemi kur fëmijët bëjnë një veprë të mirë dhe na dëgjojnë". Një vjehrrë që të gjithë do ta donin apo jo?



Shpati e ka gjetur nusen, por nëna është kundër? "Vajzat e mira i gjen në fakultet, jo në diskotekë!"

turës dhe profesioneve që keni mbaruar shkollën?

Ka një pikë takimi midis profesionit dhe pikturës dhe ajo është balanca ime. Nëse njëra më mban me këmbë në tokë, tjetra më jep gjithë lirinë e fantazisë, ëndrrave dhe botës sime të brendshme.

A keni ndonjë piktor/e të cillin e studioni apo edhe frymëzoheni. Është dikush që i përqaset stili juaj i punës?

Jackson Pollock. Jam e apasionuar pas pikturës së tij. Megjithatë kjo nuk definon shijet e mija në pikturë pasi nuk jam e lidhur vetëm

me stilin e tij por sesi vijnë tek unë pikturat e tij. Kjo do të thotë që nuk limitohem në një aspekt të pikturës, por shkoj më tej.

Së fundmi keni folur për një ekspozitë që do të hapni me veprat tuaja. Kur do ta realizoni?

Vështirë të them një datë të saktë, por le të shpresojmë që sa më shpejtë.

A keni menduar ndonjë emër për ekspozitën që përfshin apo i bashkon frymën e gjithë veprave?

Ende jo, por, besoj dhe emri i ekspozitës do më vijë në një moment që as vetë s'do e kuptoj se si.



BULEVARDI

POLITIK

Na merrni seriozisht!

Dy presidentët Meta dhe Pahor shijojnë ushqimin shqiptar bio

Presidenti i Sllovenisë Borut Pahor zhvilloi një vizitë në Tiranë me takime të shumta. Gjatë ditës së djeshme ai bashkë me kreun e shtetit shqiptar Ilir Meta kanë vizituar një biznes privat familjar në kryeqytet. Njoftimin për këtë vizitë e bëri publik Presidenti Meta me një shënim në faqen e tij në "Facebook". "Kënaqësi e veçantë që së bashku me Presidentin e Sllovenisë, Borut Pahor të vizitonim sot (dje) Uka Farm, një biznes model e familjar i mbështetur fort në traditën më të mirë të prodhimeve shqiptare bio", shprehet z.Meta.



Berisha më në formë se kurrë, nuk i bën gjë as gazi lotsjellës

Sh-kryeministri Sali Berisha njihet për karakterin e tij të fortë edhe sportiv. Këtë anë të karakterit të tij nuk harron ta tregojë edhe këto ditë protestash për opozitën, ku ai jo vetëm që ka qëndruar nga fillimi deri në fund të tyre, por edhe ka mundur të përballet edhe me gazin lotsjellës të përdorur shpesh nga policia. Edhe dje ai qëndroi për afro 3 orë në protestën para Kuvendit, ndërsa shoqëroi protestuesit deri te KQZ dhe u kthye bashkë me ta në selinë e PD. Pavarësisht orëve të gjata të qëndrimit në këmbë ai është dukur goxha në formë. Duke marshuar drejt selisë së Partisë Demokratike, Berisha ka folur me gazetaren e "News24", Klodiana Lala. Ndërsa gazetarja i ka vënë në dukje se duket në formë pasi policia përdori gaz lotsjellës dje në protestë, Berisha tha se edhe me gaz është në formë. "Edhe me gaz jam në formë unë, nuk ka asgjë që më pengon për të vazhduar betejën mua", - tha Berisha.



E bija mbush 4 vjeçe, Spiropali: M'u shfaqe në eko më e madhe se bota

Elisa Spiropali, ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin është nënë e një vajze të quajtur Nalta, e cila mbush mbushi 4 vjeç. Në këtë ditëlindje, Spiropali i bën një dedikim publik ku shkruan: "Nalta, sot je 4 vjeçe. Tashmë ke filluar të vishesh vet. Kur flet, më nuk belbëzon. Kur këndon, nuk stonon. Kur reciton, aktron. T'a uroj këtë ditëlindje ty bija ime që m'u shfaqe në ekran në ekon e parë, grimcë më e madhe se bota, më e dhimbshur se jeta, më e dashur se gjithçka". Spiropali publikoi dhe një foto, ku të dyja, nënë e bijë, shijojnë detin.



Zgjidhja gjeniale e policisë, leu shtyllat me graso që të mos prishnin kamerat

Krahas masave të shumta të sigurisë të marra për garantimin e zhvillimit të një seance normale parlamentare, Policia e Rendit kishte marrë dje dhe një masë të veçantë shtesë, që rrallë kujt mund të shkonte mendja. Nisur nga precedentët e mëparshëm ku protestuesit kanë hipur nëpër shtylla dhe kanë dëmtuar kamerat e sigurisë dhe altoparlantët me anë të të cilëve bëhej thirrje protestuesve të respektonin ligjin dhe rendin publik, Policia e Shtetit kishte lyer të gjitha shtyllat e ndriçimit përpara Kuvendit me graso makinash. Kjo për të bërë të pamundur hipjen e protestuesve në shtyllat e ndriçimit dhe dëmtimin e kamerave të reja të sigurisë dhe altoparlantëve të vendosura ditë e fundit në ambientet para Kuvendit. Siç shihet edhe në foto, që në orët e para të mëngjesit punonjës dhe mjete të policisë bënë të mundur lyerjen e tyre me graso.

Këshilla

Gjatë verës lëkura e fytyrës ka nevojë për lagështirë të vazhdueshme, gjatë dimrit për mbrojtje nga e ftohta, ndërkohë që gjatë pranverës nevojitet një terapi e veçantë vitaminash. Kujdesemi për fytyrën në pranverë, por, kjo nuk do të thotë që duhet tejkalluar përdorimi i tyre. Sasia e madhe e vitaminave (madhe dhe vitamina C) mund të shkaktojë hipervitaminë, që çon në tharje, skuqje dhe dehidratim të pjesshëm të lëkurës. Për këtë arsye e shëndetshme është taktika dyfishe: Marrje e brendshme në masë e vitaminave dhe aplikimi jashtëm i produkteve kozmetike me përmbajtje vitaminoze. Zakonisht, me vitamina pasurohet kozmetika e përditshme, qofshin këto kremra për ditën apo natën. Për këtë arsye ato mund të përdoren jo vetëm në periudha që mungojnë vitaminat, por gjithmonë kur lëkura ka nevojë për përkujdesje.

CILAT VITAMINA TË ZGJEDHIM? LËKURA E THATË

Nëse me afrimin e pranverës lëkura juaj bëhet shumë e thatë, përdorni produkte kozmetike që përmbajnë më tepër vitaminë E. Vendoseni atë çdo natë me ndihmën e një tamponi pambuku në pjesët e thata të fytyrës, trupit dhe në rrudhat e thella. Edhe ju vetë mund të pasuroni kremën që do të përdorni nëse shtoni disa pika vitaminë E, e cila shitet në farmaci. Nëse lëkura juaj është dëmtuar nga i ftohti, kërkon kombinimin e vitaminës E me vitaminën A. Kremi e duarve, i cili përmban këto dy vitamina, mund ta përdorni edhe për zbutjen e bërrylave, gjunjëve, thembrat e këmbëve apo për buzët e plasura. Ne ju rekomandojmë dy maska shtëpie, të cilat përmbajnë vitaminë A dhe E. 1. Në mbrëmje hidhni në ujë të zierë një grusht me kajsji të thata, ndërsa në mëngjes shtypini dhe shtoni 2 lugë kafeje kos. Mbajeni për 15 minuta në fytyrën tuaj dhe do të shihni që ajo do të zbutë lëkurën. 2. Grini hollë majdanoz (ai përmban shumë vitaminë A) dhe shtoni vaj. Do të përfitoni një

maskë të jashtëzakonshme.
LËKURA E YNDYRSHME

Nëse gjatë pranverës lëkura juaj bëhet poroze dhe e yndyrshme, ju mund të shmangni puçrrat e pakëndshme duke përdorur kombinimin e vitaminës E dhe C. Maska në kushtet e shtëpisë. Përzieni një lugë gjelle fruta të thata me një

lugë gjelle grurë dhe zhytini në ujë të nxehtë. Shtoni 15 pika limoni të freskët dhe vendoseni maskën e fituar për 20 minuta. Ajo do të pastrojë porët tuaja dhe do të rinojë ngjyrën e fytyrës tuaj. Shenjat e krijuar nga puçrrat mund t'i hiqni me ndihmën e majdanozit të prerë hollë të përzierë me kripë. Ai për-

doret në formën e piling-ut.
VITAMINA C


Një nga vitaminat më të rekomanduara për lëkurën është vitamina C. Ajo përmirëson proceset e shkëmbimit, aktivizon funksionet mbrojtëse të saj, mbron muret e enëve të gjakut, përmirëson ngjyrën e lëkurës dhe normalizon ndarjen e yndyrave nga

djersa. Mund të "përkëdhelni" lëkurën tuaj me këtë vitaminë nëse shtypni pjesën e brendshme të çdo lloj agrumi dhe shtoni kos natyral pa përmbajtje sheqeri. Mund të bëni edhe maskë për fytyrën nëse përzieni pataten ose lakrën e bardhë me niseshte patateje. Përdorni pa problem fruta dhe perime të ngr-

ira. Kur e dini se për çfarë vitaminash ka nevojë lëkura juaj, në fund të verës mund të blini edhe "ilaçet" e shijshme. Pastroni frutat ose perimet, grinjini hollë ose shtrydhini dhe shtoni 1 lugë gjelle vaj. Më pas futeni në një qese dhe grinjini. Kështu do të keni gati dhe maskat për dimrin e ardhshëm.



Si të kujdesemi për lëkurën gjatë pranverës?



Ministria e Financave publikon listën me dosjet që ka shqyrtuar nga janari deri në tetor 2018

Ish-të përndjekurit, 5 mijë trashëgimtarët që marrin paratë

Dokumentet që duhet të plotësojë çdo përfitues

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshtëpërblijm dhe kështu të tretë duhet të dorëzojnë dokumentet në Ministrinë e Financave. Janë në total 5 mijë përfitues, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e Pagesave nga janari deri në tetor të vitit të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e përfituesve me të gjitha detajet për çdo dosje. Në listën e publikuar shënohet me "V" në rastet kur dokumenti është në rregull, me X kur është gabim dhe është kolona bosh kur dokumenti nuk është paraqitur.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumta e dëmshtëpërblijm kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimit apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës

nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq është i domosdoshëm një vendim fakti gjyqësor që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative e lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave.

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIA BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNG UT FAMILJAR	DESHIMI TRASHIGIMIE	PROKURE	CERTIFIKATE PER CDO NDRYSHIM IDENTITI
FATIME	REXHAI					V	V	V		
SHEQJET	REXHAI					V	V			
	VALDETE	ZALLI		V	V					
	VALENTINA	MADANI		V	V					
	VALMIRA	REXHAI		V					P	
	BESNIK	REXHAI		V						P
	FLORIN	REXHAI		V						P
	VALBONE	REXHAI		V						P
	SHKELQIM	REXHAI		V	V			V		
ZEF	MARKU					V	V	V		
	DAVA	NIKOLLI		V						P
	LULA	NIKOLLI		V						P
	PJETER	MARKU		V	V			V		
ANDONETA	PAPAHRISANTHU					V	V	V		
PAVLI	PAPAHRISANTHU			V	V					
KOCO	PAPAHRISANTHU			V	V					
IRINI	ORGOCKA			V	V					
LUVIGJ	VUKAJ			V	V		V	V		V
PJETER	VUKAJ			V						P
PRENDE	NILAJ			V						P
GJON	VUKAJ			V						P
NDUE	VUKAJ			V						P
KATRINE	TINAJ			V						P
						V	V	V		
TEFTA	DEROMEMAJ			V						P
HAJDAR	DEROMEMAJ			V						P
PETRIT	DEROMEMAJ			V						P
SKENDER	DEROMEMAJ			V						P
ILIR	DEROMEMAJ			V						P
ESMA	SHASKA			V						P
FETI	DEROMEMAJ			V	V			V		V
						V	V	V		
PAL	GURI			V						P
MARIE	DEMA			V						P
KATRINE	VATAJ			V						P
PRENDE	MHILLI			V						P
ANGJELINA	DEMA			V	V					V
LEZE	PJETRI			V						P
GJELOSH	GURI			V						P
	VLADI	GURI		V						P
						V	V	V		
ABDULLAH	BERHAMI					V	V	XFKOPIE		
	SHPETIM	BERHAMI		X	X					
	FATBARDH	BERHAMI		X	X					
	ROLAND	BERHAMI		X	X					
	BESNIK	BERHAMI		X	X					
SULEJMAN	BERHAMI					V	V	V		
	ERIOLA	MISKA		V	V					
	DORINA	BERHAMI		V	V					
BUKURJIE	BATHORJA			V	V					
NEXHMI	BERHAMI			V	V					
BEDRIE	KERTUSHA			V	V					
						V	V	V		
HUZRIE	NEZHA					V	V	X		
QAZIM	NDREU					V				
	HAZIS	NDREU		V						P
ABDI	NDREU									
	ARSHI	NDREU		V	V					V
	KADIFE	HOXHA		V						P
	ALLTANE	HOXHA		V						P
						V	V	V		
HAJRIDE	ALLA			V	V					
AISHE	KULLAFI			V	V					
AHMET	ALLA			V	V					
XHANE	BARDHI			V	V					

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIA BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUNG UT FAMILJAR	DESHIMI TRASHIGIMIE	PROKURE	CERTIFIKATE PER CDO NDRYSHIM IDENTITI
NEXHMJUE	LALA					V	V			
MEREME	BALLA					V	V			
HANIFE	SINA					V	V			
								V	V	V
ARIFE	HOXHA							V	V	V
SALI	HOXHA			V	V					
NEFARET	HOXHA			V	V					
VANGJEL	THOMAJ			V	V					
FATIME	DOLLANI			V	V					
KADENE	ZENELI			V	V					
								V	V	V
RIZA	RUSI					V	V	V	V	
ZYLIIHA	RUSI					V	V	V	V	
SIDKI	RUSI					V	V	V	V	
	ADRIAN	RUSI		V	V					
	MIMOZA	DACI		V	V					
	MIRJAM	TAIPI		V	V					
	SHPRESA	RUSI		V	V					
ABDYL	RUSI					V	V	V	V	
	ORMIR	RUSI		V	V					
	VILMA	TAIPI		V	V					
EQEREM	RUSI					V	V	V	V	
	RIZA	RUSI				V				
	NERMIN	TUZI		V	V					
	INDIRA	BALA		V	V					
THABIT	RUSI			V	V					
BAHRI	RUSI					V	V	V	V	
	GAZJON	RUSI		V	V					
MAKBULE	RUSI (BUSHATI)					V	V	V	V	
						V	V	V	V	
ALIDJIE	BREGU			V	V					V
MIRELA	VRAPI			V	V					
ELIRA	BREGU			V	V					
CLIRIM	BREGU			V	V					
KLAUDI	BREGU			V						P
						V	V	V	V	
LEZE	ÇUNAJ					V	V	V	V	
	SHUK	ÇUNAJ		V	V					V
	PINE	KRONI		V	X					REV
	GJON	ÇUNAJ		V						P
	DILE	ÇUNAJ		X	X					
	MARJIE	PJETRI		V	V					REV
	NDOC	ÇUNAJ		V	V					REV
	TOM	ÇUNAJ		V						P
						V	V	V	V	
FRROK	PRENGA									
	MARK	PRENGA		V						P
	NDUE	PRENGA		V	V					V
						V	V	V	V	
DILAVER	LAMKA									
	ASTRIT	LAMKA		V	V					
						V	V	V	V	
SHAQIBE	GIOLEKA					V	V	V	V	
AGIM	GIOLEKA			V	V					
DRITA	PROKO			V	V					
FATO	BUSHI (BUSHAJ)					V	V	V	V	
	SUELA	BARKAJ		V	V					P
	ARTEMIDA	KOÇIRAJ		V	V					V
						V	V	V	V	
DAUT	DAUTI					V	V			
	RAMIZ	DAUTI		V	V					
	NAXHIDE	NOKA		V	V					
	SAKIP	DAUTI		V	V					
	MUSTAFA	DAUTI		V						V
	FIQIRETE	KOLTRAKA		V	V					
						V	V	V	V	
SULEJMAN	KURTI					V	V	V	V	
NAFJUE	NOGA					V				
LETE	LLESHI					V	X			
		ILIR	NOGA	V	X					
		LILJANA	VALTERI	V	V					V
		VERE	VALTERI	V	X					
NIHAT	KURTI			V	X					
BESNIK	KURTI					V	V	V	V	

Opinion i Ditës

Bajram Hallkoki, oficeri që shkroi Ullsonit

Nga ILJAZ ISMAILI

... presidentit Ullson, Letrën me kërkesat e shqiptarëve.

Në vitin 1914, Bajram Hallkoki ishte në luftë me rebelët, të cilët ishin kundër Princ Vidit, e pro Greqisë dhe Serbisë.

Më 24 dhjetor të vitit 1914, trupat italiane pushtuan Vlorën. Admirali italian Patrisi, zbarkoi me 1000 ushtarë detarë në Skelë, të cilët u pasuan me ardhjen e regjimentit të X-të të bersalierëve, nën komandën e kolonel Moskos. Burri i madh e poeti brilant Ali Asllani, i cili atë kohë ishte zvendësiprefekt, shkoi në konsullatën italiane dhe pyeti konsullin: Pse zbarkojnë ushtarë italianë në Skelë, në një kohë kur këtu mbretëron rregulli dhe qetësia? E konsulli italian iu përgjigj: "Nuk të takon ty, të pyesësh për këtë, pasi është marrë vesh Roma me Durrësin" (lexo: Esatin).

BËNË DHE SHKRUAN HISTORI...

Familjet e mëdha shqiptare, janë quajtur të tilla, nga bijtë që ata bëjnë në shërbim të atdheut. Më së shumti, ato familje nxorën nga një pinjoll, që la emër të pashlyeshëm me shërbesat që bëri për atdheun.

Sa për të ashtuquajturat familje "të mëdha", ato që morën ofiqet e otomanëve dhe timaret prej tyre, i ka gjykuar dhe do t'i gjykojë historia, sado të jenë në numër shkarravitësit që shkruajnë për to.

Por janë pak, shumë pak familje të mëdha, që nxorën dy apo edhe më shumë bij të lavdishëm, të cilët i shërbyen atdheut me përkushtim patriotik të pa cak, secili në fushën ku shkëlqente.

Njëra nga këto familje, është Familja Hallkoki e Vlorës, dy bijtë e së cilës-Sali dhe Bajram Hallkoki, bënë vepra që kohë nuk mundën t'i shlyejnë.

Vëllai i madh, Sali Hallkoki, ishte njëri nga personalitetet më të spikatura të Shqipërisë në gjysmën e parë të shekullit të njëzet. Kryeakademiku i këtij vendi, e kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Prof. Aleks Buda, shkruante: "Sali Hallkoki është një intelektual i shquar i vendit tonë". Kurse profesor Skënder Luarasi, kur Zogu e vrau Sali Hallkon pas shpine në vitin 1936, si shumë të tjerë, do të shkruante: "Po të mos e kishte vvarë Zogu Sali Hallkoki, Shqipëria do të krenohet me mendjen e tij enciklopedike" ... Saliu është autori i së parës Histori të shkruar të Shqipërisë, "Histori e Shqipërisë së Re", botim i vitit 1923.

Ashtu siç është autori i të parit Fjalor Enciklopedik ("Fjalori Gjithfarësh" e quante ai), por edhe i "Fjalor Kombiar i Kulturës dhe Historisë", e i shumë veprave të tjera, të cilat u morën e u përdorën nga "doktorët" e ardhshëm të këtij vendi. Të vërtetën lakurike për këtë fakt, e tha Prof. Gazmend Shpuzha në përrurimin e Monografisë me autor prof. Bardhosh Gaçe në datën 10 maj 2005, në sallën e SHQP-it që patëm: "Ne



historianët shqiptarë, le të mos fshihemi pas gishtit tonë të vogël. Të gjithë e kemi shfrytëzuar veprën e Sali Hallkos. Unë konkretisht, dy gradat e para shkencore, i kam mbrojtur bazuar në punimet e tij"...

Kurse kryetari i Akademisë së Shkencave Prof. Ylli Popa në presidiumin e asaj sale, tha: "Ju vlonjatët, krenoheni se Sali Hallkoki ishte vlonjat. ... Gabim e kemi, sepse ai i kishte kapërcyer kufijtë e Vlorës, e të Shqipërisë"

"Zotëruet i gjuhëve frënge, greke, perse, turke dhe italiane, ai kishte një zotësi të rrallë arsytimi për ngjarjet, për zhvillimet politike dhe diplomatike, sidomos në pasqyrimin e gjallë të historisë së popullit shqiptar"(Bardhosh Gaçe, Monografia, fq 92, bot. 2005)...

LUFTOJ, POR "NUK SHKROI", AI QË...

Vëllai i tij më i vogël Bajram Hallkoki-oficer, përveç përkushtimit të pa fund ndaj çështjes kombëtare si njeri i arsimuar e i kultivuar, ishte pajosur nga natyra edhe me një oratori të pasqor. Ai bashkë me Avni Rustem, Jani Mingën, Memo Meten etj, ishin oratorët më të përgatitur që e ngrinin Vlorën në këmbë, për të luftuar kundër pushtuesve.

Bashkëpunëtor dhe luftëtar në krah të Avni Rustemit, Jani Mingës, Thoma Papapano, Kolë Kamësi, Osman Haxhiu, Halim Xhelu, Memo Mete etj, Bajram Hallko ishte njëri ndër personalitetet e spikatura të viteve 1911-1925.

Viti 1915, e gjeti Shqipërinë jo vetëm shesh luftime, por edhe me tre "qeveri-ra shqiptarë": "qeveri" e Shkodrës, "qeveri" e Durrësit (Esati)-Shqipëri e mesme, "qeveri" e Musa Qazimit, si dhe dy "qeveri-ra" të huaja, atë italiane në Vlorë, dhe gjithë viset e Veriut nën "qeverinë" e Serbisë. Traktati i fshehtë i Londrës, kishte realizuar të gjitha pazaret e bëra mes "aleatëve" dhe Esati Toptanit...

Kurse në marsin e vitit 1916, trupat italiane në Shqipëri numëronin mbi njëqind mijë ushtarë. E në 15 shtator 1916, në zyrë e shtetit "sh-

qipitar", valonte vetëm flamuri italian, duke e lidhur Vlorën me Leçen, si një provincë të saj...

E në shenjë mirënjohjeje për shërbesat e çmuara, ata e emëruan Esatin, edhe "Princ i Shqipërisë së Mesme"...

Ashtu siç do të emëronin në vitin 1925 kryeministër, e në vitin 1928, edhe... "mbret të shqiptarëve", vetë nipin e Esatit-Ahmetin, edhe këtë, për shërbesat e çmuara kundrejt tyre.

Si ushtarak i zoti e atdhetar i përkushtuar, ai luftoi në krye të trupave shqiptare, në të gjithë Shqipërinë. Qysh nga zona e Cakranit kundër austriakëve, kundër grekëve në Gjirokastrë e Përmet, kundër serbëve deri në vitin 1921, në Dibër, Mirditë dhe në Dukagjin. Ashtu siç ishte në krye të ushtarakëve shqiptarë në Dhjetor të vitit 1924, në betejat e Kërrabës dhe Shkallës së Tujanit kundër sllavëve, që po sillnin Zogun në fronin që u nevojitej atyre...

...I SHKROI LETËR ULLSONIT!

Janë drejtuar shumë letra e nota proteste, nga shumë shqiptarë patriotë e shoqata patriotike drejtuar Konferencës së Paqes në Paris. Ashtu siç edhe nga argatë të regjuri të huajve.

Sepse, "Ishte arritur një dasi ndërshqiptare, ndonëse jo fort e dukshme, ku muhamedanët thirreshin "turq", ndërsa ortodoksët "grekë" apo "kaurë". Kjo ndodhi..."Për shkaqet e njohura, se njëri përpiqej për "babën" e tjetri për "papën", njëri për din, e tjetri për kryq"(Sali Hallkoki "Historia e Shqipërisë së Re" bot. viti 1923, fq. 238).

Por vetëm një letër arriti në Amerikë, në zyrën e presidentit. Sepse, në janar 1919, me porosi të Ullsonit e me urdhër të Departamentit të Shtetit Amerikan, do të mbërrinte në Shqipëri konsulli i SHBA-ve në Torino, Jozeph Haven, "Për të parë gjendjen në vend, e për të hetuar dëshirat e popullit shqiptar"...

Diplomati amerikan përshkoi gjithë vendin, në jug dhe në veri. Por kudo që shkonte, ishte nën

mbikëqyrjen e rreptë të trupave italiane, e personalisht të gjeneral Ferreros(Ferrero ishte komandant i trupamatës së XVI italiane të pushtimit në Shqipëri).

Në pamje të parë, dukej sikur italianët kujdeseshin për sigurinë e tij. Në fakt, ishte kreu e kundërta. Ata nuk donin të lejonin komunikimin e tij me shqiptarët.

"E para armë e shenjtë, e para kryengritje kombëtare, është ajo e Përmetit më 6 mars 1919, e cila tronditi aq keq politikën italiane, saqë gjeneral Ferrero mori qortime të rënda nga eprorët e tij në Romë. Delegati amerikan, erdhi në Përmet si në gjithë Shqipërinë, i shoqëruar nga bajonetat italiane, të cilat kujdeseshin të mos kishte veprime patriotike. Nën zë, italianët thoshin se "shqiptarët janë të egër, e mund të vrisnin delegatin amerikan". Por më 6 mars dy oficerë shqiptarë, Bajram Hallkoki dhe Demo Korça përmes bajonetave italiane i dhanë në dorë diplomatit amerikan një letër për Ullsonin. Letra për presidentin amerikan, ishte shkruar në dy gjuhë, anglisht dhe frëngjisht.

Mbasi shkoi në zyrë dhe e lexoi, ai ftoi në zyrë të dy oficerët, me të cilët bisedoi për dy orë rresht, pa praninë e italianëve.

Në letër shkruhej: "Populli i krahinës së Përmetit, i mbledhur sot në një miting proteste energjik dhe kundër kërkesave imperialiste të Venizellos, bazuar në parimet e proklamuar nga Presidenti i SHBA-ve Ullson, të pranuar prej aleatëve, kërkon ndreqjen e padrejtesive që iu bëjnë Shqipërisë në Konferencën e Londrës 1912-1913, e cila shkëputi Kosovën në favor të Serbisë dhe Malit të Zi, Çamërinë në favor të Greqisë, ku shqiptarët atje, vazhdojnë të vuajnë të këqijat e njohura. Konferenca e Parisit duhet të korrigjojë gabimet e Londrës, të na kthejë Janinën, Manastirin dhe Kosovën. Të drejtën e nëpërkëmbur nga Konferenca e Londrës e kërkojmë sot, se vetëm ashtu do mund të rrojmë të qetë. Ndryshe s'do të pushojmë së kërkuari, pasi i kemi trashëgim

nga stërgjyshërit tanë. Ne e duam Shqipërinë nën mbrojtjen e Amerikës dhe pa protektoratin e Italisë, "etnografike, të lirë e vetqeverimtare"...(Gazeta "Dielli", Nr. 1484, Boston Mass, datë 28 mars 1919, f.1-2).

Diplomati u premti oficerëve, se letra e tyre do t'i shkonte në dorë presidentit amerikan. Dhe letra shkoi në zyrën e tij. Argatët qëllim-këqij(që thonë se ai nuk la gjë të shkruar), le të kërkojnë në Bibliotekën e parlamentit amerikan, se atje e kanë letrën e përpiluar nga Bajram Hallkoki.

Kuptohet, sa u largua amerikani, të dy oficerët u burgosën. Populli i Përmetit, por edhe xhandarët shqiptarë u ngritën me armë, të fyer nga ky veprim. Shpartalluan burgun dhe i nxorën oficerët. U vranë shtatë ushtarakë nga forcat e pushtuesve italianë. Italia, u tronditi nga veprimi i Bajram Hallkos dhe Ferreros tha: "Nuk e dija se ai ishte kundër nesh". Populli i Përmetit, qysh atë ditë ngriti këngën: "S'njoha gjë, më plaçin sytë/ Që kur s helmova Bajramnë/ Unë e quaj nga të mitë/ Ai bëkej propagandë"...

Nërsa Esati ato ditë, i shkruante delegacionit italian në Paris që... "Italia të ruajë mandatin e saj mbi Shqipërinë dhe të marrë në dorëzim portin e Vlorës"(Monografia B.Gaçe, fq. 238-239).

E Myfiti i dërgonte telegram Turhan Pashës, që kryesonte delegacionin shqiptar në Paris. Beu i Libohovës i kërkonte atij të jepte miratimin, për të kaluar Shqipërinë e Jugut, "nën garancinë e mbrojtjen e Italisë"(Muin Çami "Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar,1918-1920"(Përmbledhje dokumentesh, Akademia e Shkencave RPSH, Instituti i Historisë 1976, fq.71)...

Familja Hallkoki, mbeti gur kilometrik i Historisë, sepse kurrë ndër shkuj nuk hëngri bukën e të huajt, kurrë nuk jetoi me rrogat e pushtuesve, e kurrë nuk u vu në shërbim të tyre. Sepse kurrë nuk shfrytëzoi djersën dhe gjënë e të tjerëve, por jetoi me djersën e vet...

Njëri nga pasardhësit e Bajram Hallkokit(Hazis-në mos gaboj e quajmë), i tha një argati qëllim-keq: "Po "Guri me Qiejl", për të cilin ju shkruani, çfarë ka lënë të shkruar"???

Pra, bijtë e kësaj familjeje, i kryen më së miri detyrat ndaj Atdheut. I shërbyen atij si shumë pak të tjerë, me mendje e me pushkë, kurdo e kudo që e lypi nevoja. Askush nuk mund të thotë se duhej të bënin edhe diçka tjetër: Madje u sulmuan, u burgosën, u vranë pas shpine, u përzunë vetëm për faktin se besonin që Atdheu i tyre(pra i yni) do të mund ecte përpara, në një rrugë tjetër.

Ata e kthyen me jetët dhe veprat e tyre atë familje, në një gur kilometrik të historisë sonë kombëtare...

Opinioni **i** Ditës

E dashur Europë, Brexit është një mësim për të gjithë ne

Nga Emmanuel Macron

...Qytetarë të Evropës, nëse po marr nismën t'u adresohem drejtpërdrejt, nuk është vetëm në emër të historisë dhe vlerave që na bashkojnë, por, sepse koha është thelbësore. Pas pak javësh, zgjedhjet evropiane do të jenë vendimtare për të ardhmen e kontinentit tonë. Që nga Lufta e Dytë Botërore Evropa kurrë nuk ka qenë aq thelbësore. Megjithatë, nuk ka qenë kurrë në një rrezik të tillë. Brexit qëndron si simbol i kësaj. Ai simbolizon krizën e një Europe që nuk ka arritur t'i përgjigjet nevojës së popullit për t'u mbrojtur nga goditjet e mëdha të botës moderne. Ai gjithashtu simbolizon kurthin evropian. Kurthi nuk qëndron në të qenit pjesë e Bashkimit Evropian; kurthi është të një gjenjeshtr dhe papërgjegjshmëria që mund ta shkatërrojë atë. Kush i tha popullit britanik të vërtetën për të ardhmen pas Brexitit? Kush u foli atyre për humbjen e aksesit në tregun e BE? Kush i përmendi rreziqet për paqen në Irlandë për rivendosjen e kufirit? Kalimi në nacionalizëm nuk ofron asgjë; është refuzim pa një alternativë. Dhe ky është kurthi që kërcënon të gjithë Evropën: shton zemërim, mbështetur nga lajme të rreme, që premtojnë asgjë dhe çdo gjë.



Emmanuel Macron, Presidenti i Francës.

Ne duhet të qëndrojmë të fortë, krenarë dhe të kthjellët, përballë këtij manipulimi dhe së pari, të themi se çfarë në të vërtetë është Evropa. Është një sukses historik: pajtimi i një kontinenti të shkatërruar është një projekt i pashembullt i paqes, prosperitetit dhe lirisë. Le të mos e harrojmë kurrë këtë. Dhe ky projekt vazhdon të na mbrojt sot. Cili vend mund të veprojë më vete përballë strategjive agresive nga fuqitë kryesore? Kush mund të pretendojë të jetë sovran, vetë, përballë gjigantëve dixhitalë? Si do t'i rezistojmë kësaj të kapitalizmit financiar pa euron, që është forcë për të gjithë BE-në? Pjesë e Europës janë, gjithashtu, ato mijëra projekte të përditshme që kanë ndryshuar fytyrën e rrugeve tona: shkolla të rinovuara, rrajë të ndërtruara dhe interneti me shpejtësi të lartë. Kjo luftë është një angazhim i përditshëm, sepse Evropa, si paqja, nuk mund të merret kurrë si e mirëqenë. E ndjek atë pa u lodhur, në emër të Francës, në mënyrë që ta çojë Europën përpara dhe të mbrojë modelin e saj. Ne kemi treguar se gjërat që u thanë ishin të paarritshme, krijimi i një aftësie mbrojtëse evropiane dhe mbrojtja e të drejtave sociale, ishin, në fakt, të mundshme.

Ne duhet të bëjmë gjithnjë e më shumë, sepse ka një kurth tjetër: kurthi i status kuosë dhe heqja dorë. Të ballafaquar me krizat e mëdha në botë, shpesh qytetarët pyesin: "Ku është Evropa? Çfarë po bën Evropa?" Për ta ajo është bërë një treg pa shpirt.

Megjithatë, Evropa nuk është thjesht një treg ekonomik. Është një projekt. Një treg është i dobishëm, por nuk harrohet nevoja për kufij për të mbrojtur dhe vlerat që bashkojnë. Nacionalistët janë të gabuar kur pretendojnë të mbrojnë identitetin tonë duke u tërhequr nga BE, sepse është qytetërimi evropian që na bashkon, na liron dhe na mbron. Por ata që nuk do të ndryshojnë asgjë, po ashtu janë të gabuar, sepse e mohojnë frikën e ndjerë nga populli

ynë, dyshimet që dëmtojnë demokracinë tona. Ne jemi në një moment thelbësor për kontinentin tonë, një moment kur së bashku ne kemi nevojë për të ripërtëritur politikisht dhe kulturalisht formën e qytetërimin tonë në një botë në ndryshim. Tani është koha për një rilindje evropiane. Prandaj, duke rezistuar tundimit të izolimit dhe ndarjes, unë propozoj që ta ndërtojme këtë së bashku rreth tre ambicieve: Liria, mbrojtja dhe përparimi.

Mbrojtja e lirisë sonë Modeli evropian bazohet në lirinë: e njerëzve, të diversitetit të mendimeve dhe të krijimit. Liria jonë e parë është liri demokratike: liria për të zgjedhur udhëheqësit tanë teksa fuqitë e huaja kërkojnë të ndikojnë në votat tona në çdo zgjedhje. Unë propozoj krijimin e një Agjencie Evropiane për Mbrojtjen e Demokracisë që secili shtet anëtar i BE-së të ofrojë ekspertë evropianë për të mbrojtur procesin e tyre zgjedhor kundër sulmeve kibernetike dhe manipulimeve. Në këtë frymë të pavarësisë, ne duhet të ndalojmë financimin e partive politike evropiane nga fuqitë e huaja. Duhet të kemi rregulla evropiane që të shmangin nxitjen e urrëjtjes dhe dhunës nga interneti, pasi respekti për individin është themeli i qytetërimin dhe dinjitetit tonë.

Mbrojtja e kontinentit tonë E themeluar mbi pajtimin e brendshëm, BE ka harruar realitetet e botës. Megjithatë asnjë komunitet nuk mund të krijojë një ndjenjë përkatësie nëse nuk ka kufij territorialë të mbrojtur. Kufiri është liri në siguri. Prandaj ne duhet të rishikojmë zonën e Shengetit: të gjithë ata që duan të jenë pjesë e saj duhet të përmbushin detyrimet e përgjegjësitë (kontrolltet e rrepta kufitare) dhe solidaritetin (një politikë e vetme për azilin me rregulla të përbashkëta të pranimit dhe refuzimit).

Do na duhet një forcë e përbashkët kufitare dhe një zyrë evropiane për azilin, detyrime të rrepta kontrolltet dhe solidaritet evropian, në të cilat secili vend do të kontribuojë nën autoritetin e Këshillit Evropian për Sigurinë e Brendshme. Për sa i përket migracionit, besoj në një Evropë që mbron vlerat dhe kufijtë e saj.

Të njëjtat standarde duhet të zbatohen për mbrojtjen. Progres i konsiderueshëm është bërë në dy vitet e fundit, por ne duhet të vendosim një kurs të qartë. Një traktat mbi mbrojtjen dhe sigurinë duhet të përcaktojë detyrimet tona themelore në bashkëpunim me NATO-n dhe aleatët tanë evropianë: rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes, një klauzolë të vërtetë të mbrojtjes së ndërsjellë dhe një këshill evropian të sigurisë, me Britaninë e Madhe në bord, për të përgatitur vendimet tona kolektive.

Kufijtë tanë, gjithashtu, duhet të garantojnë konkurrencën të ndershme. Cili vend në botë do të vazhdojë të bëjë tregti me ata që nuk respektojnë asnjë nga rregullat e tyre? Nuk mund të vuajmë në heshtje. Ne duhet të reformojmë politikën tonë të konkurrencës dhe të riformesojmë politikën tonë tregtare, penalizojmë ose ndalojmë bizneset që komprometojnë interesat tona strategjike dhe vlerat themelore siç janë standardet mjedisore, mbrojtjen e të dhënave dhe pagesën e drejtë të taksave; dhe miratimin e platformës evropiane në industritë strategjike dhe prokurimin tonë publik, si bëjnë konkurrentët tanë amerikanë dhe kinezë.

Ringjallje shpirtit të përparimit Evropa nuk është një fuqi e nivelit të dytë. Ajo në tërësi e saj është një forcë në pararojë: ajo gjithmonë ka përcaktuar standardet e përparimit. Në këtë, Evropa duhet të çojë përpara një projekt konvergencë me shumë se ai i konkurrencës: Evropa, ku është krijuar siguria sociale, duhet të prezantojë një mburojë sociale për të gjithë punëtorët, duke garantuar pagë të njëjtë për të njëjtën punë dhe një pagë minimale të BE-së, për çdo vend, të negociuar kolektivisht çdo vit.

Rifutja në rrugën e duhur, gjithashtu, nënkupton të çojmë përpara të kujdesin ndaj mjedisit. A do të jemi në gjendje t'i shohim fëmijët tanë në sy nëse nuk lajmë borxhin tonë ndaj klimës? BE duhet të vendosë objektivin e saj - zero karbon deri në vitin 2050 dhe pesticidit të jenë përgjysmuar deri në vitin 2025 - dhe t'i përshatë politikat e saj në përputhje me masat e tilla si krijimi i një Banke Evropiane për Klimën për të financuar tranzicionin ekologjik, një forcë evropiane

të sigurisë ushqimore për të përmirësuar kontrolltet tona ushqimore, masa kundër lobimeve, vlerësim i pavarur shkencor të substancave të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin. Ky imperativ duhet të udhëheqë të gjithë veprimet tona: nga Banka Qendrore të Komisionin Evropian, nga buxheti Evropian te Plani i Investimeve për Evropën, të gjitha institucionet tona duhet të kenë klimën si mandatin e tyre.

Progres dhe liri do të thotë të jemi në gjendje të jetojnë nga puna e gjithsecilit: Evropa duhet të shikojë përpara për të krijuar vende pune. Kjo është arsyeja pse ajo ka nevojë jo vetëm për të rregulluar gjigantët dixhitalë duke vendosur mbikëqyrjen evropiane të platformave kryesore digjitale (dënime të shpejta për konkurrencën e pandershme, algoritme transparente etj.), por edhe për të financuar inovacionin duke i dhënë Këshillit të ri Evropian të Inovacionit një buxhet në të njëjtin nivel me Shtetet e Bashkuara në mënyrë që të çojë përpara rezultate të reja teknologjike, si inteligjenca artificiale.

Një Europë e orientuar drejt botës duhet të shohë nga Afrika, me të cilën duhet të lidhim një marrëveshje për zhvillimin e ardhshëm afrikan me investime, partneritete akademike dhe edukim për vajzat. Liria, mbrojtja dhe përparimi: ne duhet ta ndërtojmë përtëritjen evropiane në këto shtylla. Nuk mund të lejojmë që nacionalistët pa zgjidhje të shfrytëzojnë zemërimin e njerëzve. Nuk mund të ecim në gjumë në një Europë të zvogëluar. Ne nuk mund të qëndrojmë në rutinën e ditës me idenë se është një ditë rutinë si gjithë të tjerat. Humanizimi evropian kërkon veprim. Dhe kudo, njerëzit janë çuar në këmbë për të qenë pjesë e këtij ndryshimi. Pra, deri në fund të vitit, le të sjellim, me përfaqësuesit e institucioneve të BE-së dhe shtetet anëtare, një Konferencë për Evropën, me qëllim që të propozojmë të gjitha ndryshimet që nevojiten për projektin tonë politik, të hapur edhe për ndryshimin e traktateve të BE-së. Kjo konferencë duhet të angazhojë panellet e qytetarëve dhe të dëgjojë akademikët, përfaqësuesit e biznesit dhe punëtorët, si dhe udhëheqësit fetarë dhe shpirtërorë. Do të përcaktojë një udhërrëfyes për BE-në i përkthen këto prioritetet kryesore në veprime konkrete. Do të ketë mosmarrëveshje, por a është mirë të kemi një Europë statike apo një Europë që përparon, ndonjëherë me shpejtësi të ndryshme dhe kjo është e hapur për të gjithë?

Në këtë Europë, njerëzit do të marrin kontrollin e së ardhmes së tyre. Në këtë Europë, Britania e Madhe, jam i sigurt, do të gjejë vendin e saj të vërtetë. Ngecja e Brexitit është një mësim për të gjithë ne. Na duhet të ikim nga ky kurth dhe të bëjmë zgjedhjet e ardhshme dhe projektin tonë kuptimplot. Ju takon ju të vendosni nëse Evropa dhe vlerat e progresit që ajo mishëron, duhet të jenë më shumë se vetëm një episod kalues në histori. Kjo është zgjedhja që unë u jap: së bashku të përcaktojmë rrugën për përtëritjen evropiane.

HOROSKOPI

DASHI
Dikush që ka një tendencë për t'i bërë gjërat më të vështira se sa duhet të jenë, mund të transmetojë energji negative tek ti. Mos e lejoni këtë gjë edhe nëse do t'ju duhet të tregoheni pak i ashpër ndaj tij.

DEMI
Sot do të përmbytyri nga këshillat e të tjerëve. Veproni siç jua thotë instinkti dhe mos u ndikoni nga askush. Buzëqeshni me komentet e tyre dhe pastaj ndihuni i lirë që t'i shpërfillni ato.

BINJAKET
Zbulimet e reja mund t'ju befasojnë sot dhe gjithashtu mund t'ju edukojnë! Kur dikush që e keni menduar se e njihni brenda dhe jashtë, vepron në një mënyrë krijësisht të habitshme, mos u frikësoni.

GAFORJA
Ju mendoni se po flisni mjaft qartë, por njerëzit e tjerë mund t'ju keqpëtojnë. Në ajër ka një mjegull të ngatërruar, dhe shpjegimi i ideve të komplikuar do të jetë shumë e vështirë. Këto mosmarrëveshje mund të lindin edhe në dashuri.

LUANI
Instinkti juaj i gjashtë po bëhet shpejt kuptim juaj ndaj nuk duhet të hezitonit që të mbështeteni tek ai! Tani për tani vizioni juaj është i paqartë për shkak të dëshirave tuaja të shumta. Përqipni të vini në zbatim planin tuaj në biznes.

VIRGJERESHA
Vetëm punë dhe aspak argëtim nuk është gjëja e duhur. Mos u shqetësoni aq shumë për punën ose shkollën dhe filloni të eksploroni aspektet më romantike të jetës suaj. Përqipni të shijoni muzikën, modën dhe artin të cilat stimulojnë emocionet tuaja.

PESHORJA
Kur të hyri sot në një situatë të re, kujdesuni për disa njerëz që duan të marrin të gjithë kontrollin. Ata mund t'ju shohin si konkurrencë (edhe nëse nuk jeni) dhe ju japin më pak se një mirëseardhje të ngrohtë. Çfarëdo që të bëni, mos e merrni si personale këtë supë të ftohtë.

AKREPI
Thjeshtësia është parulla e sotme. Mbani gjërat të thjeshta dhe do të keni një ditë fantastike! Në punë ose në shkollë, mos u shqetësoni me prezantime të komplikuar plot skema. Në jetën tuaj të dashurisë, mos krijoni skena dramatike.

SHIGJETARI
Sot, do të dalë në dritë një informacion i ri dhe kjo mund të bëjë që ju të ripërkufizoni një nga vlerat tuaja. Një person pa shtyllë kurriore po lëkundet në jetën tuaj - dhe kjo do të jetë një ndjenjë e lodhshme.

BRICJAPI
Gjëja e mënyrave krijuese për të fituar ose për të kursyer para do të jetë një sfidë e këndshme për ju sot. Gjatë muajve të ardhshëm, pasuria juaj në mënyrë të bërë që dëson njerëzit të jenë shumë zijaq për ju. Nëse kjo ndodh, ndani sekretet tuaja për suksesin financiar!

UJORI
Thuhet se fëmijët kanë nevojë për disiplinë në mënyrë që të jenë të lumtur dhe të shëndetshëm, por dhe të rriturit kanë nevojë për rregulla në jetën e tyre gjithashtu! Ti e di se cila është zgjedhja e duhur, prandaj përqipuni që ta bëni atë për të arritur atje ku doni.

PESHQIT
Lejojeni ngrohtësinë tuaj të dalë në sipërfaqe në çdo situatë të vështirë dhe gjithmonë do t'ia dalësh me sukses. Çdonjëri dëshiron të qëndrojë me njerëz që i bëjnë të ndihen mirë. Prandaj largojini njerëzit negativë nga rrethi juaj.

ZHVILLIMET E FUNDIT

Kristian Panuçi mund t'i japë lamtumirën që këtë javë përfaqësueses shqiptare të futbollit, me një lëvizje të papritur e që do të ishte një goditje shumë e rëndë për ngjyrat kuqezi, vetëm pak javë para fillimit të eliminatorëve të "Euro 2020". Gjithçka lidhet me Eusebio Di Françeskon dhe aventurën e tij te Roma,



Di Françesko ikën, Panuçi merr Romën të enjten?

e cila pritet të mbyllet të mërkurën në darkë. Sipas mediave italiane, Di Françesko nuk pëlqen aspak faktin që vihet gjithmonë në diskutim dhe si në rast kualifikimi, ashtu edhe eliminimi e do t'u japë lamtumirën italianëve pas ndeshjes kundër Portos. Italianët janë të bindur që lajmërimi do të vijë pas ndeshjes dhe për këtë arsye, klubi po zgjidh gjithçka me shpejtësi për të qenë i përgatitur që të enjten që të bëjë të ditur emrin e trajnerit të ri. Gjithashtu, në mediat italiane shihet Kristian Panuçi si kandidati më i

mundshëm për të marrë drejtimin e skuadrës deri në fund të këtij sezoni. Ai është në garë me Paulo Sousa, por vetë në klub duan një ish-futbollist që njeh ambientin, ndaj zgjedhja bie tek ai. Siç është shkuruar edhe në ditët e mëparshme, vetë Panuçi është gati t'i japë lamtumirën Shqipërisë, pasi mund të ndërpresë me një penallitet minimal kontratën që ka lidhur në vitin 2017.

Presidenti i FSHF-së flet për ngjarjen e fundit në Kamëz nga një aktivitet në Elbasan



Dhuna ndaj arbitrit në sfidën Kamza-Laçi ka tronditur në thellim futbollin shqiptar. Armand Duka thyen më në fund heshtjen nga Elbasani, por më shumë se sa më dorë të hekurt, ka folur si diplomat, si anëtar i Komitetit Ekzekutiv në UEFA. Sigurisht që dënon dhunën, por në fund të fundit ky është realiteti shqiptar dhe pa prezencën e Policisë së Shtetit është shumë e vështirë që të shmangen incidente të tilla. Cilat do të jenë masat që do të merrni për dhunën?

Duka: Duhet policia në stadium, tifozët nuk kanë kulturë si Anglia

Kreu i federatës dënon dhunën dhe pret reagim



para 5 vjetësh apo 7 vjetësh, kështu që një goditje që të duhet shumë punë që ta rikuperosh.

Mendoni që ka bërë mjaftueshëm federata për t'i minimizuar këto raste?

E thashë disa herë që masat e Komisionit të Disiplinës kundër fenomeneve të dhunës apo gjeveve antisportive kanë qenë më se normale, apo në respekt të rregulloreve të lojës.

Ndërpritet kampionati nëse policia nuk e kthen një lloj vendimi duke qenë që problematika është?

Unë pres që të kemi një reagim ndryshe dhe të ulemi dhe të bisedojmë ndryshe. E thashë, për mua është e pamundur, në fakt edhe për shumë të tjerë. Në realitetin që jemi do ishte shumë bukur që futbollit dhe çdo lloj aktiviteti tjetër të mos kishin policin, po të ishte me stjuart apo me njerëz civilë,

por a është e mundur në nivelin e kësaj shoqërie?! Unë them jo. Nëse do funksiononte si një mekanizëm perfekt që çdo shkelës pasi ta bënte atë, të thirrej, të dënohej goftë dhe me 1 mijë lekë gjobë, atëherë edhe mund të shkojmë në vendimin që të mos ketë polici në stadium. Kishim në Korçë, ku 150 njerëz hynë në stadium, bënë çfarë deshën, thyen gjithë atë stadium që me shumë vështirësi e kemi ndërtuar dhe ashtu nuk u thirr, goftë edhe për t'i dhënë edhe një masë 100 lekëshe. U dhunua fotografi në Tiranë, në ndeshjen kundër Partizanit, një zyrtar ndeshjeje. Agresorët ishin të filmuar, nuk ke ç'kërkon më shumë. Nuk u ndalua askush. E njëjta gjë ndodh edhe tani. Kështu që nëse nuk funksionojnë këto, atëherë duhet të ketë forca rendi në stadium.

Anglia dhe Norvegjia kanë nevojë për aq shumë policë sa ishin sot në mëngjes në parlamentin shqiptar, sepse parlamentarët nuk flasin dot me njëri-tjetrin. Kanë një polici jashtë dhe një Gardë brenda dhe niveli i futbollit, që është akoma edhe më i gjerë dhe presupozohet se niveli intelektual duhet të jetë pak më pak se i parlamentit duhet të luajë dhe të ruajë vendin vetë pa policinë. Federata ka marrë masa sportive, vetëm atë ka në dorë. Duhet që të gjithë bashkë të bëjmë më të mirë. Patjetër që çdo goditje lë shenjë, do të duhet shumë kohë që kjo të harrohet. Do ndërpritet kampionati? Unë pres që kë të një reagim ndryshe nga policia, pasi realiteti shqiptar nuk mund të bëjë pa policinë në stadium.

kohë dhe tashmë që ndodhi, me të drejtë disa njerëz kujtojnë... por ka ndodhur edhe

KOMBËTARJA GJERMANE

Lëv nis revolucionin, jashtë tre lojtarë të Bajernit

Eliminimi i Gjermanisë në Kupën e Botës që në fazën e grupeve u ka kushtuar shumë rëndë lojtarëve titullarë, që kanë mbajtur peshën e skuadrës në vitet e fundit. Sipas asaj që shkruajnë mediat gjermane, Joakim Lëv së bashku me menaxherin e Kombëtares gjermane, Oliver Bierof, kanë shkruar në Mynih për t'u takuar me tre nga titullarët e kësaj skuadre. Takimi ka qenë i rëndësishëm dhe Lëv u ka komunikuar tre titullarëve të Bajernit të Mynihut dhe përfaqësueses se nuk ka ndërmend t'i grumbullojë më ata në të ardhmen, duke u shpjeguar dhe arsyet e këtij vendimi. Lojtarët e skarcuar janë Mat Humels 31 vjeç, 70 ndeshje me Gjermaninë, Zherom Boateng 31 vjeç, 77 ndeshje me Gjermaninë, dhe Tomas Myler 30 vjeç, 100 ndeshje me Gjermaninë. Lëv pritet t'u japë përparësi elementeve të rinj për të ndërtuar një tjetër skuadër cilësore si ajo që ndërtoi 10 vite të shkuara, me të cilën arriti të shpallet kampion bote në Botërorin e zhvilluar në Brazil në vitin 2014.

MANÇESTER JUNAJTID

Lukaku-Pogba, sherr për një penallti

Sulmuesit të Mançester Junajtidit, Romelu Lukakut, nuk i ka pëlqyer aspak vendimi i shokut të ekipit, francezitet Pol Pogba, që të godiste penalltë, duke i hequr blugut mundësinë për të realizuar një tregolësh. Mançester Junajtidit priste Saumthamptonin dhe mesfushori i Kombëtares franceze këmbënguli që ta godiste ai penalltinë, e cila mund ta çonte rezultatin në 4-2 për "dajtë e kuq". Pogba e gabo i 11-metërs dhe kjo tërhoi pa masë Lukakun, që kërkoi llogari me tone të ashpër ndaj mesfushorit, ndërsa u desh ndërhyrja e shokëve të skuadrës për t'i ndarë ata. Ngjarja u komentua dhe nga trajneri Solskjaer; që ndër të tjera tha: "Patën një debat me tone shumë të ndezura, sepse Lukaku nuk ishte aspak i kënaqur me atë që bëri Pogba". Tashmë mbetet për t'u parë sesi do të sillen lojtarët në fushë në ndeshjet e ardhshme.




SITUATA

Inter-Ikardi, tani do të nisë betejat ligjore

Sipas asaj që raporton "Corriere dello Sport", Suning tashmë është fokusuar për epokën e re, atë pa Mauro Icardin në ekip. Kjo vërtetohet nga imazhet që klubi zikaltrë ka zgjedhur si dëshmitarë komercialë. Janë Skriniar, De Vrij, Handanović, Lautaro Martinez dhe Perisic, por jo Icardi, me të cilin krisja tashmë duket e parikuperueshme, pas takimit që sulmuesi pati me Spalatin dhe mjekun e Interit. Ndaj, Suning ka nisur epokën post-Ikardi, i përjashtuar nga billboardet e Aux Group. Ish-kapiteni ka refuzuar me një "jo" të thatë të rikthehet të stërvitet me grupin, duke vijuar të ankohej për një dhimbje të fortë në gju, ndërsa ndërmjetësve u është përgjigjur në mënyrë të rëndë: "Kjo është hera e fundit që flas me ju për këtë temë". Tashmë duket se i vetmi që mund të kthejë qetësinë në dhomat e zhveshjes është Zhang, që do të ketë një takim ballë për ballë me Icardin. Por nëse argentinasi vijon të mos stërvitet me skuadrën, javët e ardhshme mund të nisnin dhe përballjet ligjore, ndonëse rasti është i paksa i komplikuar në këtë pikë.

Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL**
- Dillon aktor.
 - Një listë që zgjidhet nga regjisor
 - Sigla e tritolit.
 - Kapiteni që ndiqte balenën Moby Dick.
 - Eshtë spektatori i yni.
 - Fillojnë lejen
 - Një sinjal akustik.
 - Një parashetës për... përtej.
 - Eshtë partia e Sali Berishës.
 - Kanë organizatën Hamas.
 - Gëlojnë nga murgjit.
 - Në teori kur mungon ti.
 - Inicialet e Gide.
 - Inicialet e Asimov.
 - Nisen na pe.
 - Kreshniku i volejbolit.
 - Kufijtë e tokës.
 - Mund të jenë autonome të tilla.
 - Britma e Arkimedit.

- Fillojnë vetëm.
- Bota jashtë ëndrrës.
- Mund të jenë ushtarake.
- Italia në Internet.
- Gjysmë atomik.
- Janë prova inteligjence
- Një libër hartash.
- Clapton i muzikës.

VERTIKAL

- I famshëm ai i Trojës.
- Një... bombë tenisnike.
- Fillojnë themelet.
- Mund të jetë klasifikimi.
- Një letër... kampioni.
- Eshtë pozicioni për gjumë.
- Janë diktatorët despotikë.
- Një kryeqytet afrikan.
- Qe mesfushor i famshëm i Ajax.
- Ekstremit në tenis.
- Eshtë e dendur në xhungël.
- Eshtë brijnë në skuadër.
- Eshtë pako që dërgohet.
- Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- Bëjnë taktika me taka.
- Vetot pa kufij.
- Persekutoni romakët.
- Eshtë gri ajo e trurit.
- Një mund të jetë spiuinzi.
- Janë vendet për nisje.
- Me to bëjnë torta.
- Janë katër në kitarë bas.
- Institucione Urbane Rajonale.
- Priten me lotë në sy.
- Një rreth pa ekstreme.
- Gjysmë kasate.
- Eshtë cilësia.
- Ente Tregtare Lokale.
- Një pjesë e territorit.
- Në hyrje të oazit.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Jagger i Rolling Stones.
- Zanore për kuaj.
- Janë dhelpira.
- Inicialet e Lendl ish tenist.
- Kufizojnë rastet.
- Mbyllen me epilog.
- Eshtë simbol ngadalësie, por jo breshkë.
- Gjysmë njeriu.
- Janë fruta ekzotikë.
- Një minierë e vjetër.
- Ata tanë ish in ilirë.
- Masat pa kufij.
- Një gëzim i madh.
- Agjenci Ndërmjetëse Përmet
- Eshtë godinë në miniaturë
- Film i Ridley Scott
- Duken të gjata në pritje.
- Njëzetmijë... në det në një libër të Jules Verne.

VERTIKAL


- Një legjendë.
- Përfundojnë një stil.
- Nuk e ulin kokën.
- Këndohen në opera.
- Janë tek në Somali
- Eshtë lloj papagalli.
- Mbyllin komentim.
- Eshtë e parë për prodhim.
- Kush ka do të pijë.
- Janë binarë.
- Rolet pa ret.
- Vihen për të mbyllur të tilla.
- Janë tek në mantel.
- Salgari që krijoi Sandokan.
- Një stinë e ngrohtë.
- Janë pamje nga puna.
- Një fjalë goxha.
- Ato Eilijams janë teniste
- Ishin të parët tanë.
- Janë edhe ato polare.
- Fillojnë nazet.
- Inicialet e Triolet.
- Një bëhet me pozë.
- Mbyllin punimet.
- Ndodh në kufij.
- Perignon i champagne-s.
- Eshtë iks ajo e sulmit.
- Enti evropian i hapësirës.
- Fillojnë lehtë.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

H E S A P E T T P A B C
 E M I R A T E A R A B E T
 L I K E R B E T O N E T
 E L S A D R I V A L E T
 N R B U R I M E T J A
 M A R O K E N E O D A T
 F U L L A N I E M E A
 P L A A T O M I K E
 A N S T E R E O O L T
 P A R S I D M A R T A
 A N A N I A P R E S I O N
 S A R D O U D E T I T A

FJALËKRYQI (2)

S P O L E M I K A E L
 V K A N A R I N A E N A
 A L V A T I K A N I E N
 J O E I N T E T E M A
 R T M A R A D E T T A
 A R I A N A A R U N T K
 T A L E N T M A U R I C E

SUDOKU

3				1		7
				2		
2	1		4	5		8
		7	9	4		6
	9	8				
	2	9	3			
1		5				
6			8			4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	6	4	8	9	7	3	1	5
1	9	5	2	3	6	8	4	7
3	7	8	1	4	5	2	9	6
6	2	7	9	5	1	4	8	3
4	5	1	3	7	8	6	2	9
8	3	9	6	2	4	5	7	1
5	8	6	4	1	9	7	3	2
9	4	2	7	6	3	1	5	8
7	1	3	5	8	2	9	6	4

Argëtim filozofik

- Hapi i parë për të arritur gjërat që dëshiron në jetë është: vendos çfarë do.
- Njerëzit në përgjithësi gjykojnë më shumë nga fenomenet sesa nga realiteti... ndërsa konceptimi të paktëve ...
- Kur bëni një zgjedhje, mos mendoni nëse kjo është e drejtë apo e gabuar ... Mendto të jetë vetëm ajo që me të vërtetë ti dëshironi!!
- Ata që munden, bëjnë. Ata që nuk munden, gjykojnë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

13	4	15	8	14	4	14	7	4	15			
4	11	4		1	8	12	2	3	14	5	10	
10		1		4	1	2	8	10	6	4	7	5
4	7		1	7	5	8	9	4	2	10	4	
15	3	1		6	2	10	5	2	6		12	
7	1	11	13	5		1	5		17	15	11	
17	3	10	13	3		4	4	4	10	6	3	
4		2	4	7		11		6	10	4	2	4
12	1	5	16	4	10	5		4	4		8	16
14	4	7	4		8	14	5		17	3	10	10
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	5	4
2	4	2	5		4	1	2	8	10	6		2

C O S T N E R I P A V
 I L R M I I K L A
 R K O P E R N I K U N
 K O O P E R A T I V A T
 K L I N I K E L F
 T R O K E I R O N I K E
 R S A L T E V I T A
 I T A L I A S E E V A
 U L E M A R T A C
 M A E J E A N L I J A
 F U T U R I S T E T A R

Chënie të mençura

- Të njohësh vlerën tënd! Kur i jepni veten tuaj dikujt që nuk ju respekton, ju jepni pjesë të shpirtit tuaj që kurrë nuk do t'i merri më pas.
- Bëni gjithmonë atë që dëshironi, por të jeni, para se gjithash njerëz që dinë se ç'dëshirojnë.
- Mos dashuro dhe as mos urre, mos premtro dhe as mos beso verbërisht.
- Nëse një ditë do të më kërkosh dhe nuk do të ekzistoj më... vetëm mos harro se dikur isha atje për ty ... dhe ti nuk dite të më vlerësosh.

